

**Rifilloi
grykimi**
"Monstra" e
pret PSP-në

Fq.5



**BUXHETI 2018
I KULTURËS**
Ndëshkimi
i radhës për
teatrot shqiptar


Fq.8



**Heroi
i madh i
"Camp
Nou"**

Leo Messi

Fq.22



Koha

www.koha.mk



**Populist i
djathtë dhe
mysliman!**

Fq.17

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3291 · e martë 13 shkurt, 2018

-1°C | 5°C

15 DEN

KULTURË

**Filozofia
poetike
në prozën
e Besnik
Mustafajt**



Romani 'Autoportet me teleskop' i shkrimtarit Besnik Mustafaj është një produkt i pastër letrar, që vjen pas një heshtje të gjatë krijuese, por që gjithë këtë heshtje ai sikur e justifikon me veprën e fundit, e cila për shumëçka është unike në mbarë letërsinë moderne shqipe. Në radhë të parë, ajo është një manifest estetik i shkruar në vazhdimësi, madje edhe para se autori të vendoste të shkëputej... Fq.13

AKTUALE

**Për katër vite,
15 mijë nxënës
më pak!**

Fq.6

RAJON

**Vrasja e
Ivanoviqit,
Beogradi nuk
i përgjigjet
Prishtinës**

Fq.16



EDHE KJO JAVË PA SEANCË PARLAMENTARE

VAZHDON ZVARRITJA E SHQIPES



As takimi i dytë i së hënës i Talat Xhaferit me shefat e grupeve parlamentare nuk dha ndonjë rezultat konkret përveç asaj që javën e ardhshme - në koordinimin e radhës janë marrë vesh që të caktohet data dhe strategjia për shqyrtimin e 35 mijë amendamenteve të VMRO-së kundër Ligjit për gjuhët

Fq.3

Universitetet shqipe me tri lëndë në maqedonisht!

Shkup, 12 shkurt - Propozim-ligji i arsimit të lartë që pritet të nixret së shpejti, përveçse është i rëndësishëm për frymën dhe rregullimin që do të marrin në të ardhmen institucionet e arsimit të lartë në Maqedoni, është në të njëjtën kohë edhe një test për shqiptarët, respektivisht për institucionet e arsimit të lartë në gjuhën shqipe, si dhe për përfaqësuesit politik në Parlament. Me këtë propozim-ligj,

njëjtë si me Ligjin e përparshëm, universitetet në gjuhën shqipe do të duhet të sigurojnë mësimdhënie në gjuhën maqedonase në të paktën tre lëndë për secilin program studimor. Nëse nuk ndodhin ndryshime në pjesën "Gjuhët në të cilat zhvillohet mësimi", pra nëse propozim-ligji miratohet si i tillë, të gjithë studentët e Universitetit të Tetovës (UT), Universitetit të Evropës Juglindore...

Fq.6



EDITORIAL

**(DE)MISTIFIKIMET
KULTURORE**

Emin AZEMI

Lidhjet tona me botën shprehin kulturën dhe vokacionin shpirtëror e material të njerëzve dhe ideve që ata bartin. Shpesh na ka rënë të shohim kartolina me pamje nga Maqedonia nëpër vende të ndryshme të botes. Vizitorë të shumtë gjatë qëndrimit këtu, kanë marrë me vete impresione në formë të ekspozitave, zbukurimeve, skicave, kartolinave etj.

Ajo që bie në sy tek i shikon të gjitha këto imazhe, është dominimi ekstrem i kulturës kishtarë ortodokse dhe i traditës sllave. Dominojnë ikonat, kishat, manastiret, kryqet dhe të gjitha shenjat urbane e estetike të traditës sllave-bizantine. Mund ta imagjinoni se çfarë informimi të njëanshëm për Maqedoninë marrin të gjithë ata që i posedojnë këto materiale propagandistike. Kryqëzimi i një e më shumë kulturave në Maqedoni ishte proces i natyrshëm i ngjizjes së qytetërimeve të lashta në këto hapësira. Asnjë kulturë nuk ka mundur e vetme të zhvillohet, prandaj na duket paksa absurde ky dominim i peizazheve sakrale bizantine në udhërrëfyesin turistik për Maqedoninë. Por, shtrohet një pyetje e logjikshme ku janë piktorët, skulptorët, fotografët, arkivistët, grafistët shqiptarë dhe sa ata kanë mbështetje institucionale që të prezantohet jashtë veçantësisë e kulturës shqiptare, me të gjitha specifikat e saja?

Peizazhi i bukur i vendbanimeve shqiptare, tradita e veshjes dhe jetës, stilet e ndërtimit, gdhendja e drurit, kuzhina etj., mund të jenë pikat kryesore referuese nga duhet të lëvizë vëmendja e një turisti të huaj kur vjen në Maqedoni. Bashkë me kureshtjen për të eksploruar pika ekzotike, vjen edhe potencia financiare, andaj ata që kanë ngurruar deri më tani të nxjerrin në pah vlerat kulturore e estetike të viseve dhe traditës shqiptare, është koha ta bëjnë tani. Në të kundërtën ka rrezik që shqiptarët të bien në kurthin e manipulimit mediatic, që i bënë ata jo si janë, por ashtu siç duan t'i paraqesin qarqe e institucione të caktuara këtu dhe jashtë.

Një koment i paradokshëm i gazetës amerikane "Wall Street Journal" kush-tuar Maqedonisë ka mjaftuar të shohim një kënd të posaçëm perceptimi të gazetareve të huaj për këtë pjesë të Ballkanit. "Maqedonia përballat edhe me konflikt të brendshëm kulturor. Nëse do të kishit vizituar Shkupin para një dekade, do të hasnit në një vend në buzë të luftës qytetare midis maqedonasve sllavë dhe shqiptarëve myslimanë. Bashkësia etnike maqedonase ndërton kisha dhe e vërteton identitetin e saj, ndërsa shqiptarët etnikë janë të zënë me ndërtimin e xhamive të reja", shkruante Wall Street Journal.

Konflikt kulturor? Çfarë konflikti? Kush me kë është në konflikt? Disa pyetje të munguara që ngelin pa përgjigje në artikullin e "Wall Street Journal". Dioptria e shtrembëruar dhe e reduktuar për gjoja konflikt të brendshëm kulturor vjen si pasojë e institucionalizimit të angazhimit religjioz në disa sfera publike këtu në Maqedoni. Artikullshkruesi i "Wall Street Journal" konstaton se "bashkësia etnike maqedonase ndërton kisha dhe e vërteton identitetin e saj, ndërsa shqiptarët etnikë janë të zënë me ndërtimin e xhamive të reja". Një perceptim sipërfaqësor për një problem i cili meriton analizë më të thellë. Nuk është aspak e vërtetë se kishat në Maqedoni po i ndërton bashkësia etnike maqedonase, por vetë shteti dhe më pak e vërtetë se ata po e vërtetojnë identitetin e tyre. Përkundrazi, ata madje po krijojnë konfuzitet absurd kur në njërin anë identitetin sllav e përforcuan me ndërtimin e kishave, kurse në anën tjetër u strukën në identitetin e shpifur antik, duke projektuar ngrehina që nuk korrespondojnë me mbamendjen kolektive dhe me strukturën e tyre etnopsikologjike. Kishat deri më tani e ka ndërtaur shteti, me paratë publike, të taksapaguesve të të gjitha etnive e feve dhe këtu qëndron dallimi fundamental me ndërtimin e xhamive, të cilat, megjithatë po ndërtohen me para private. Me siguri asnjë veprimtari fetare nuk do të meritonte avokati, nëse ajo e prish harmoninë etnike e fetare të një shoqërie, përfshi edhe ato të përkatësisë fetare islame.

Por, ajo çka meriton analizë dhe sqarim pas leximit të artikullit të "Wall Street Journal" dhe shumë analizave tjera që bëhen për Maqedoninë, ka të bëjë me demistifikimin e "konfliktit të brendshëm kulturor", i cili paraqitet më tepër si perceptim i largët dhe paksa i ekzagjeruar sesa si një realitet faktik. Diversiteti fetar e lingvistik i një shoqërie nuk do të konsiderohej me automatizëm si konflikt kulturor, nëse në praktikë nuk ndodhin tendenca konfrontuese që do të shfaqeshin në terren dhe në jetën e përditshme të njerëzve. Në Maqedoni, së paku, nuk ka pasur tendenca të tilla, përpos atyre të sponsoruara nga vetë shteti.

TRIUMFI I ERMALIT

"Në këto ditë të vështira kur banditët janë në krye të vendit, një kantautor i ri, Ermal Meta na fali gëzim duke triumfuar në Festivalin prestigjioz të San Remos. Triumfi i Ermalit na kujton se ka shqiptarë me talent, me energji që dinë të ecin përpara. Shqiptarë të ndershëm, krijues, të suksesshëm, njerëz të zotë dhe me vlera ka plot mes nesh, por pak bien sot në sy, sepse lajmet për Shqipërinë dhe shqiptarët i dominojnë zullumi, trafikantët dhe qeveritarët banditë.

Por e nesërmja i takon shumicës dërrmuese të shqiptarëve të ndershëm dhe me vlera. Triumfi i Ermalit është një përmendore e vlerave të vërteta të tyre. E përgëzoj nga zemra Ermal Metën për çmimin e fituar me talentin dhe punën e tij, dhe i uroj për suksese të tjera më tej! Ky është modeli që na bën krenar dhe na frymëzon si shqiptarë!", shkruan në Facebook kryetari i PD-së, Lulzim Basha

**PALEVSKI DHE "SHIPTARI" NË KUSHTETUTË**

"Nga sot organizohet kërkesë politike. Kushti për bashkëjetesë është kryqëzimi i shqiptarëve në në 'Shiptari' në Kushtetutë. Nëse mundet vend anëtar i BE-së, mundet edhe maqedonasi.

Ose do të quhemi maqedonas, ose nuk do të ketë qetësi. Drejtësinë nuk e pamë të jetojë këtu, dhe as qetësinë nuk do ta lejojmë", shkruan në FB, publicisti maqedonas, Ljupço Palevski, një nacionalist që së fundmi nënçmon shqiptarët në rrjetet sociale.

**GJYKATA KUSHTETUESE, PENG I SHITJES SË DETIT?**

"Rama i ka shitur territorin e Shqipërisë grekëve! Tregtari i kufijve ka bërë marrëveshje në fshehtësi dhe në shkelje të Kushtetutës. Askush nuk di çfarë interesi tjetër kombëtar ka tregtuar për pushtetin e tij. Gjykata Kushtetuese është në kolaps, e nuk merr dot vendime.

Nga 9 anëtarë që duhet të ketë, vetëm 5 janë sot në detyrë me mandat të plotë, ndërsa Rama po bllokoi zëvendësimin e vendeve bosh.

A mos vallë Rama e bllokoi Gjykatën Kushtetuese, që në këtë rrëmujë të drejtësisë të bëjë fakt të kryer shitjen e detit dhe gjykata të mos e anulojë marrëveshjen? Sa herë Rama bën ndonjë zullum, e quan reformë. Shihni kur ta quajë këtë Reforma e Detit. Kësaj radhe, ata që do të duartrokasnin do të jenë në Athinë", shkruan nënkryetari i grupit parlamentar të Partisë Demokratike, Oerd Bylykbashit.

NËSE NUK
E KENI DITUR...**ÇFARË ISHIN ARGATËT?**

Argatët ishin punëtorë krahu, kryesisht fshatarë të varfër që detyroheshin të punonin me mëditje sipas stinëve ose në mënyrë të përhershme, zakonisht në bujqësi dhe ndërtim. Në Shqipëri, në kushtet e sundimit osman, argatët shkonin për të gjetur punë brenda vendit ose në provinca të Perandorisë Osmane. Vinin

sidomos nga trevat malore të varfra dhe pa burime ekonomike. Argatët organizoheshin në grupe të vogla dhe mëditjen e merrnin në natyrë ose në monedhë. Me lindjen dhe zhvillimin e marrëdhënieve kapitaliste në trojet shqiptare, puna e argatëve u zgjerua më tej. Ata morën tiparet e proletarëve të fshatit dhe të qytetit.

MEDIACitate

Afër 15 kilogramë lëndë narkotike marihuanë janë konfiskuar nga një shtetas i Maqedonisë në vendkalimin kufitar Ipsala të Turqisë. Sipas të dhënave të siguruar, pas një denoncimi ekipet e sigurisë kufitare kanë kontrolluar automjetin me targa SU5328AC të drejtuar nga shtetasi i Maqedonisë me inicialet I.D., i cili ka qenë duke hyrë në Turqi. Pas kontrollit, ekipet kanë konfiskuar gjithsej 14 kilogramë e 858 gramë marihuanë të ndara në 37 pako, të cilat ishin vendosur në pjesë të fshehta të automobilit. Drejtuesi i automjetit I.D. është arrestuar.

(Anadolu Agency, 12 shkurt)

Një 44-vjeçar nga Korça me sindromin "down" dhe i prekur nga disa sëmundje kronike ka humbur jetën dy javë më parë nga gripi në reanimacionin e Spitalit të Korçës, por ngjarja u konfirmua vetëm të hënën. Vdekja është relatuar në buletinet javore të Institutit të Shëndetit Publik, por dikasteri i shëndetësisë nuk e ka njoftuar. "Vuante prej shumë vitesh nga diabeti dhe sëmundje të tjera të brendshme. Pra është tek kontigjenti i grupit të personave me risk, të cilët theksohen me forcë që duhet të vaksinohen patjetër. Gripi nuk duhet nënvlerësuar dhe vaksina parandalon vdekjen dhe parandalon format e rënda", thotë Artan Simaku, nga Departamenti i Sëmundjeve Infektive në ISHP. Shqipëria klasifikohet ndër vendet me intensitetin më të lartë të të prekurve nga virusi i gripit në këtë periudhë. Sipas specialistëve të ISHP, tanimë jemi në pikun e epidemisë, ku javën e fundit janë raportuar 23 mijë të prekur me infeksione respiratore. "Kemi arritur pikun dhe parashikojmë që në javën në vazhdim të fillojë një trend në rënie. Gripi është një nga sëmundjet më të paparashikueshme. Deri më tani nuk janë vërejtur raste të rënda. Ka raste sporadike që janë normale për stinë, por jo me të njëjtën ashpërsi si e njëjta periudhë e vitit të kaluar", shton Simaku. Por, paralelisht me epideminë e gripit në Shqipëri po qarkullon edhe virusi i fruthit. Numri i fëmijëve ka shkruar në 67, por zyrtarisht kjo nuk konsiderohet epidemi.

(Gazeta Shqip, 12 shkurt)

EDHE KJOJAVË PA SEANCË PARLAMENTARE

VAZHDON ZVARRITJA E LIGJIT PËR GJUHËT

As takimi i dytë i së hënës i Talat Xhaferit me shefat e grupeve parlamentare nuk dha ndonjë rezultat konkret përveç asaj që javën e ardhshme - në koordinimin e radhës janë marrë vesh që të caktohet data dhe strategjia për shqyrtimin e 35 mijë amendamenteve të VMRO-së kundër Ligjit për gjuhët

Koha Fatos RUSHITI

Shkup, 12 shkurt - Kryetari i Parlamentit, Talat Xhaferi, as të hënës nuk ka thirrur seancë plenare përfshirë dhe seancën e 32 me radhë në të cilën janë në rend dite ligjet që preki reformat në siguri dhe në gjyqësi, si dhe Ligji për gjuhët. As takimi i dytë dje i Xhaferit me shefat e grupeve parlamentare nuk dha ndonjë rezultat konkret përveç asaj që javën e ardhshme - në koordinimin e radhës janë marrë vesh që të caktohet data dhe strategjia për shqyrtimin e 35 mijë amendamenteve lidhur me Ligjin për gjuhët të parashtruara nga VMRO. Sipas burimeve parlamentare, kjo javë nuk parasheh asnjë seancë parlamentare për shkak të vizitave të deputetëve dhe të vet Xhaferit në Britaninë e Madhe. Sipas këtyre burimeve, takimet në Britani nuk do të përfshijë strategjinë për tejkalimin e bllokadave në Parlament, por thjeshtë çështjet buxhetore. Nga ana tjetër, as grupet e punës punuese të VMRO-DPMNE-së dhe LSDM-së të formuara me qëllim arritjen e konsensusit kombëtar për ligjet refor-



IVO KOTEVSKI

VMRO mbetet në qëndrimin fillestar se amendamentet e propozuara kanë për qëllim të bindin shumicën të kthejnë Ligjin në debat publik, ku do të merrnin pjesë shumë ekspertë të fushës, nga Qeveria dhe nga Kabineti i Presidentit. Ai Ligj është kundërkushtetues dhe ne i kemi përsëritur qëndrimet se kështu nuk mund të kalojë

muese, nuk kanë dhënë ndonjë rezultat të pritshëm. Mes ligjeve që po diskutohen në grupet e punës janë Ligji për dëshmitarë të mbrojtur, Ligji për ndjekje të komunikimeve, Ligji për Agjencinë Teknike-Operative, Ligjin për informatorët, Ligji për KSHZ-në dhe ndryshimet në Kodin Zgjedhor. Siç mësohet,

opozita do të propozojë edhe ndryshimin e procedurës për zgjedhjen e kryeprokurorit publik, respektivisht zgjedhjen e tij me 2/3 e votave dhe me Badenter, gjë që sipas opozitës - do të impononte emërim me konsensus dhe kuadër të pavarur.

Për miratimin e ligjeve ose ndryshimet në ligjet e lartpërmendura nevojiten 2/3 e votave nga numri i përgjithshëm i deputetëve. Nuk përjashtohet mundësia që brenda agjendës së ligjeve të gjendet edhe Ligji për përdorimin e gjuhëve, për të cilin opozita maqedonase kërkon që të kthehet nga fillimi në procedurë parlamentare. Por jozyrtarisht, siç raportoi gazeta KOHA ditë më parë e që u pranua edhe nga eksponatet e VMRO-së, Ligji për gjuhët është pjesë e diskutimeve në grupet punuese.

Ivo Kotevski nga VMRO thotë për gazetën KOHA se partia e tij mbetet në qëndrimin se Ligji për gjuhët duhet të tërhiqet dhe më pas ndryshimet të vijë si rezultat i një debati të madh publik mes shumë grupeve të interesit. "VMRO mbetet në qëndrimin fillestar se amendamentet e propozuara kanë



për qëllim të bindin shumicën të kthejnë Ligjin në debat publik, ku do të merrnin pjesë shumë ekspertë të fushës, nga Qeveria dhe nga Kabineti i Presidentit. Ai Ligj është kundërkushtetues dhe ne i kemi përsëritur qëndrimet se kështu nuk mund të kalojë", tha Kotevski. Në pyetjen se çka nëse nuk tërhiqen LSDM dhe BDI meqë funksionarë të lartë të dyja partive kane këmbëngulur se Ligji do të miratohet pa ndryshime, Kotevski thotë se do të marrin qëndrim pasi të shohin si do të sillen LSDM dhe BDI.

"Të shohim kur të thërrasin seancë për shqyrtimin e amendamenteve si do të sillen LSDM dhe BDI, më pas ne do të marrim qëndrim. E thash, amendamentet nuk kanë qëllimin të bllokojnë asnjëfarë agjende reformuese, por të pengojnë Ligjin për gjuhët ashtu si është, nëse pranojnë debat për ndryshim çdo gjë tjetër do të jetë e hapur për diskutim", tha Kotevski nga VMRO. Ndryshe, nga LSDM sekretari i përgjithshëm Aleksandër Kiracosvki thotë se opozita nuk duhet të bëjë taktika jo vetëm për Ligjin për gjuhët që, sipas tij, do

të shkojë për vlerësim në Komisionin Venecias as për ligjet tjera reformues. "Momenti politik në të cilin gjendet vendi ynë, nuk i jep askujt komoditet të bllokojë punën Parlamentit. As Ligji për gjuhët që do të shkojë për vlerësim në Komisionin e Venecias e që do të thotë se në rast negativ - edhe mund të diskutohen ndryshime, por as dhe për ligjet tjera që janë esenciale për kthimin e vendit në kursin reformues drejt BE dhe NATO-s, nuk duhet opozita ti kushtëzojë përkrahjen e tyre me aspekte tjera që janë çështje të organeve gjyqësore", tha për gazetën KOHA Aleksandër Kiracosvki nga LSDM. Nga BDI thonë se Ligji për gjuhët do të kalojë pa pazare politike, ngaqë sipas deputetëve të BDI-së, ky ligj ishte dhe kusht për koalicionin me LSDM-në. "Ndoshta ju kujtohet kur kryetari Ahmeti fliste për pesë opsione - mes tyre dhe ai për të mbetur në opozite nëse nuk ka marrëveshje për draft-ligjin për gjuhët. Ky ligj do të kalojë pa asnjë pazar politik me askënd. Ky ligj ishte kushti kryesor pse lidhëm koalicionin me LSDM-në", thonë deputetë nga BDI.

NIKOLLA GRUEVSKI ME AGJENDË TË NGJESHUR NË GJPSH

"BOMBAT" PËR "TANK" TË LARGOHEN NGA JOUTUBE!

Shkup, 12 shkurt - Ish-kryeministri Nikolla Gruevski, kërkon që "bombat" e publikuara për blerjen e "mercedesit", të merren merren parasysht si dëshmi në rastin "Tank". Pala mbrojtëse e të akuzuarve Gordana Jankulovska, Gjoko Popovski dhe Nikolla Gruevski, ka theksuar se katër nga gjithsej tetë "bomba" për blerjen e "mercedesit" në vlerë për 600 mijë euro, në vitin 2012, janë bërë publike. Këto zhvillime, të cilët e shënuan seancën e fundit për rastin "Tank", paraqesin një hap të ri të avokatëve të të akuzuarve nga Prokuroria Speciale Publike, të cilët i kontestojnë vetëm bisedat e publikuara. Një praktikë e tillë, ndonëse në lëndën të cilën e përfaqëson Prokuroria e Shkupit, e ka



kërkuar edhe kryeministri Zoran Zaev, i cili një kohë të gjatë këmbëngulë në largimin nga rrjeti social "Jutube" të materialeve nga Masat e Posaçme Hetuese për rastin "Ryshfeti" që zhvillohet

kundër tij. Në seancën e zhvilluar të hënës për rastin "Tank", avokatët e tre të akuzuarve e kanë konstatuar edhe kompetencën e PSP-së mbi këtë lëndë, gjegjësisht kontestimin e të gjitha mate-

rialeve të përgjuara. "Këto nuk janë MPH. Bisedat e përgjuara nuk gëzojnë një mbrojtje të tillë. Po ashtu, nuk është konstatuar autenticiteti i zërave të të akuzuarve, apo fakti se vallë këto xhirime janë të plota, ose mos janë të prera. Nuk jemi ne fajtor se pse politika e ka miratuar Ligjin për PSP-në", tha avokati Boro Tasevski. Ndaj këtyre kundërshtimeve, reagues përfaqësuesit e PSP-së, sipas të cilëve, aktakuzën për rastin "Tank" e kanë vërtetuar dy gjykatat e shkallës së parë dhe shkallës së dytë. Ndërsa sa i përket përmbytjes së "bombave" që ato i prezantojnë si dëshmi në këtë rast, prokuroria speciale Lençe Ristovska u bëri thirrje që të shkojnë në objektin e PSP-së dhe ti dëgjojnë

nga afër. Njëherësh, ajo i përkujtoi avokatët se me vendim të Gjykatës së Apelit, këto materiale mund të shfrytëzohen si prova në procedurë penale. Ndryshe, në rastin "Tank", ish-ministrja e Punëve të Brendshme, Gordana Jankulovska dhe ish-ndihmës ministri i saj, Gjoko Popovski, akuzohen për keqpërdorim të detyrës dhe autorizimeve zyrtare. Keqpërdorimi i procedurës për furnizime publike është lëndë të cilat i heton PSP në këtë rast. Ndërkaq, ish-kryeministri Gruevski, në rastin "Tank", ngarkohet për pranim të dhuratës, e cila është fituar si rezultat i ndikimit të jashtëligjshëm. Seanca e radhës për rastin "Tank" është caktuar të mbahet më 13 shkurt me fillim prej orës 11:30.

ZAEV VAZHDON VIZITËN NË TURQI

MBËSHTETJE TURKE PËR NË NATO

Të dy kryeministrat, Zaev dhe Jëlldërëm në takimin tet-a-tet dhe pastaj në nivel të delegacioneve kanë shfaqur përcaktueshmëri të kontribuojnë ndaj krijimit të kushteve për avancim të bashkëpunimit ekonomik midis dy vendeve dhe për rritjen e shkëmbimit tregtar

Shkup, 12 shkurt - Kryetari i Qeverisë së Republikës së Maqedonisë Zoran Zaev të hënën u takua me kryeministrin turk Binalli Jëlldërëm, në suaza të vizitës zyrtare të Republikës së Turqisë, i shoqëruar nga ministri pa portofol, Adnan Qahil, deputetët në Kuvend, Enes Ibrahim dhe Jusuf Hasan dhe sekretarin shtetëror në MPB, Viktor Dimovski. Në fillim të vizitës, kumtoi pres shërbimi qeveritar, kryeministri Zaev ka shprehur ngushëllim për viktimat në luftën kundër terrorizmit me qëllim të mbrojtjes së sovranitetit dhe integritetit territorial të vendit. Ka pasur pajtueshmëri nga të dyja palët se lufta kundër terrorizmit është çështje e rëndësishme për mbrojtjen e paqes botërore.

Të dy kryeministrat, Zaev dhe Jëlldërëm në takimin tet-a-tet dhe pastaj në nivel të delegacioneve kanë shfaqur përcaktueshmëri të



ZAEV PRITET NGA ERDOGANI

Presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan, ka pritur në takim kryeministrin e Maqedonisë, Zoran Zaev. Takimi Erdogan-Zaev në Kompleksin Presidencial në Ankara, ka zgjatur një orë.

kontribuojnë ndaj krijimit të kushteve për avancim të bashkëpunimit ekonomik midis dy vendeve dhe për rritjen e shkëmbimit tregtar. Është dakorduar aktivizimi i Komitetit të Përzier midis dy shteteve i cili me efikasitet do t'i zgjidhë të gjitha nevojat për një bashkëpunim të mirë në çdo nivel. Kryeministri Zaev ka bërë të ditur se nga ana e Republikës së Maqedonisë, Komitetin do ta udhëheqë ministri pa portofol, Adnan Qahil. "Për shtetin janë të rëndësishme të gjitha investimet, ndërsa Turqia është e 6-ta në Maqedoni sipas numrit të investimeve. Jemi të gat-

shëm të krijojmë kushte edhe për më shumë investime sepse ka investues të interesuar", ka theksuar Zaev. Është biseduar për mundësinë për lehtësim veçanërisht në bujqësi. "Ne sivjet presim përparim në integritet BE dhe në NATO, ndërsa presim të ndikojë në rritjen e investimeve, ndërsa me këtë edhe cilësi më të mirë të qytetarëve", ka deklaruar kryeministri Zaev. Në takimin e delegacioneve, kryeministri Zaev ka kërkuar të vazhdojë mbështetja e Turqisë për anëtarësimin e Maqedonisë në NATO, ndërsa kryeministri Jëlldërëm ka nënvizuar se Republika e Turqisë

e mbështet Republikën e Maqedonisë në këtë qëllim strategjik. Nga pres shërbimi qeveritar informuan se vazhdojnë takimet e kryeministrit Zaev në suaza të vizitës në Ankara në nivel më të lartë shtetëror.

Zgjidhja e emrit jo në dëm të Bullgarisë

Shkup, 12 shkurt - Zgjidhja për kontestin për emrin midis Maqedonisë dhe Greqisë nuk duhet që të jetë në dëm të Bullgarisë, deklaroi në emisionin e mëngjesit në BTV ish presidenti bullgar Georgi Përvanov. Zhblllokimi i dialogut midis Greqisë dhe Maqedonisë për kontestin për emrin e vlerësoi si mjaft të favorshëm,

por shprehu shqetësim për shkak të zgjidhjeve të mundshme që përmenden. "Më shqetëson ajo që fillojnë të zhvillohen bisedime në drejtim të disa zgjidhjeve prej të cilave disa nuk janë të favorshme për palën bullgare", theksoi ai. Përvanov, i cili ishte president i Bullgarisë nga vitit 2002 deri në vitin 2012 përmend

di se Bullgaria e ka njohur Maqedoninë nën emrin kushtetues. "Po ne e njohëm Maqedoninë nën emrin kushtetues dhe ishim të parët që e bëmë këtë, por supozimet e zgjidhjeve si Maqedonia e Epërme dhe Maqedonia Veriore janë në favor të Greqisë, por jo në dëm të Bullgarisë", theksoi Përvanov. Theksoi se Bullgaria

është e interesuar se si do të përfundojnë këto negociata dhe shtoi se në një moment të caktuar duhet që të ketë edhe një lloj pajtimi me palën bullgare. Sipas tij, zhblllokimi i negociatave midis Athinës dhe Shkupit para së gjithash ndodhën për shkak të presionit të Perëndimit, respektivisht të SHBA-së.

CIPRAS TREGON VIJAT E KUQE



Athinë, 12 shkurt - Emri i përbërë për përdorim të jashtëm dhe të brendshëm, për të cilin duhet ndryshim kushtetues dhe tërheqjen e të gjitha dyshimeve për qëndrime irredentiste, është korniza që e garanton mbylljen e problemit, sipas kryeministrit grek. Siç njofton korrespondenti i MIA-s nga

Emër i përbërë për brenda dhe për përdorim ndërkombëtar

Athina, Alexis Cipras në takimin e grupit të deputetëve të SYRIZA-s, përveç për ekonominë dhe skandalin Novartis, foli edhe për çështjen emrit. Tha se qeveria greke ka ndërmarrë përgjegjësi që të mbyllet problemi "me dinjitetin dhe përgjegjësinë patriotike" dhe e përsëriti pozitën e Athinës dhe kërkesat e palës greke në bisedimet.

"Zgjidhja nuk mund të jetë tjetër veç se një emër i përbërë, i cili do të vlejë për të gjithë, për përdorim të përgjithshëm. Diçka për të cilën gjithsesi, parakusht është edhe ndryshimi kushtetues, që emri me të vërtetë të jetë erga omnes, gjegjësisht për përdorim të përgjithshëm. Nuk mund të jetë një përdorim jashtë, ndërsa tjetër

të jetë emri në Kushtetutë. Gjithsesi parakusht është edhe tërheqja e çdo dyshimi për irredentizëm. Kjo është korniza e vetme që e garanton zgjidhjen e problemit dhe kalimin në epokë të re për tërë Ballkanin, larg nacionalizmit, fanatizmit dhe jotolerancës", tha Cipras, transmeton MIA. Kryeministri grek u përqendrua edhe në protestën në Athinë duke komentuar se qeveria nuk i injoron protestuesit dhe në mënyrë indirekte dërgoi mesazh deri tek të gjithë ata që kërkuan "të mos jepet emri Maqedoni".

"Dëshiroj të pyetem, cili është mesazhi i kësaj proteste? Mesazhi për karakterin grek të historisë së Maqedonisë dhe të Lekës së Madh dhe trashëgimisë së tij? Nëse ky

është mesazhi, atëherë mendoj se janë duke trokitur në dyer të hapura. Mesazhi është të mos kërkojmë zgjidhje të problemit i cili është hapur prej vitit 1992? Nëse ky është mesazhi atëherë është i gabuar dhe është në llogari të interesave kombëtare. Ose ndoshta mesazhi është, siç thanë shumë prej folësve, mos e jepni emrin Maqedonia? Nëse kjo është kërkesa, nuk duhet të gjykojmë nëse është e gabuar ose e drejtë, pasi që para se të gjykojmë nëse është e gabuar apo e drejtë, duhet ta themi të vërtetën, se është jashtë kornizave të realitetit. Pasi që as kjo qeveri as cilado tjetër prej vitit 1992 e andej nuk u ballafaqua me dilemën e tillë nëse duhet ta japë emrin, shumë thjeshtë pasi

që emrin Maqedoni, Greqia mirë apo keq, e ka pranuar që para shumë vitesh", tha Cipras. Ai, duke folur para deputetëve të SYRIZA-s, sqaroi se Greqia që në kohën e Jugosllavisë e ka pranuar termin Maqedonia në emrin e vendit tonë, ndërsa ky pranim ka vazhduar me emrin e përkohshëm IRJM, në të cilin, siç tha, shkronja M do të thotë Maqedoni. Tani, Qeveria dhe vendi, sipas Cipras, nuk janë thirrur të japin diçka, që është dhënë prej të tjerëve, por të marrë mbrapa, disa punë të caktuara. Kryeministri grek theksoi se nuk do të jenë negociata të lehta, por se nuk ekziston një rrugë tjetër, përveç se të vazhdohet me negociatat me vendin fqinj që të gjendet "zgjidhje e pranueshme e përbashkët".

Pranojmë emër Maqedonia e Epërme, pa përkthim

Athinë, 12 shkurt - Pa përkthim në gjuhën greke, emri Maqedonia e Epërme, ashtu siç shqiptohet në gjuhën maqedonase, është zgjidhje e pranueshme për Stavros Teodorakis, lideri i partisë greke, Potami. Siç njofton korrespondenti i MIA-s nga Athina, nën sloganan "Kohërat kërkojnë guxim dhe përgjegjësi", Teodorakis, para anëtarëve të organit më të lartë të lëvizjes, fliste për ngjarjet e fundit në Greqi, mes të cilëve edhe çështja e emrit dhe rasti me kompaninë farmaceutike, Novartis. "Ne guxojmë dhe e ndërmarrim përgjegjësinë dhe themi se e pranojmë termin Maqedonia e Epërme, të papërkthyer ashtu siç ishte propozuar te fqinjët tanë. Kërkojmë t'i ndryshojnë librat e tyre, kërkojmë të lirohen nga irredentizmi, por u themi, kur të bëhet e gjithë kjo, do t'i shtrëngojmë duart dhe do të dakordohemi, sepse ashtu siç tha Kami, e ajo vlen edhe për ta edhe për ne: "E dua shumë atdheun tim që të jem nacionalist", tha Teodorakis. Lidhur me protestat për "mbrojtje të Maqedonisë", lideri i Potamit, theksoi se nuk kanë kurrfarë pika të përbashkëta me folësit dhe slogonet e tubimeve, me ato të cilët mbrojnë "një Greqi të frikësuar", Greqi që gjithkund sheh komplotë". "Greqia nuk do të dominojë në Ballkan sepse do të vendosë veto. Do të dominojë, nëse dominon, si forcë primare në ekonomi dhe kulturë", tha Stavros Teodorakis, transmeton MIA.

RIFILLOI GJYKIMI PËR VRASJEN E PESËFISHTË NË LIQENIN SMILKOVËS



“MONSTRA” E PRET PSP-në

Hetimet e PSP-së për rastin “Monstra”, ashtu siç shpeshherë kanë njoftuar nga kjo prokurori, janë duke u zhvilluar një kohë më të gjatë dhe për këtë arsye, avokati Raufi beson se kjo prokurori së shpejti do të përfshihet në këtë lëndë, për shkak se edhe ekzistojnë biseda të përgjuara për këtë lëndë

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 12 shkurt - Rigjykimi i rastit “Monstra”, të hënën para Gjykatës Penale të Shkupit ka filluar me leximin e aktakuzës së vjetër. Për familjarët, avokatët dhe të akuzuarit që për disa muaj me radhë mbrohen në liri, kjo aktakuzë aspak nuk është e qëndrueshme. Faktin se kjo lëndë të ardhmen e saj e ka të lidhur ngushtë me Prokurorinë Speciale Publike, më së mirë e shpjegon fakti se përfaqësuesi i Prokurorisë për krim të organizuar, Naum Panovski, shumë pak ishte i përgatitur gjatë kohës kur e lexoi aktakuzën e vjetër. Me qëllim ose jo, ky prokuror i cili për opinionin është i njohur si prokuror i cili e zhvilloi lëndën për “Lagjen e Trima-ve”, të hënën bëri një lëshim teknik dhe nuk e lexoi aktakuzën për të akuzuarin Sami Luta. Reagimi i palës mbrojtëse, por edhe i vetë Sami Lutës, ishte arsyeja se pse kjo lëndë u prolongua për tu gjykuar më 14 mars. Avokati i një pjesë të të akuzuarve, Naser Raufi, duke e komentuar lëshimin e prokurorisë, tha se bëhet fjalë për një lëndë komplekse, të cilën vetë prokurori nuk e ka analizuar deri në fund para se të paraqitet në seancë. “Kjo lëndë përbëhet nga dy aktakuza të posaçme, të bashkuara në një. Në këtë rast, përfaqësuesi i Prokurorisë për krim të organizuar e lexoi vetëm aktakuzën e parë ku janë të përfshirë Halil Demiri, Afrim dhe Agim Ismailoviq, Fejzi dhe Haki Aziri, me përja-

shtim të Sami Lutës. Problemi i sotëm ishte i natyrës teknike dhe për arsye, kjo seancë u anulua. Me rëndësi është se ky rast po gjyket nga e para dhe se e njëjta pritet të zhvillohet në mënyrë transparente dhe të drejtë”, tha avokati Raufi.

Hetimet e PSP-së, për këtë rastin “Monstra”, ashtu siç shpeshherë kanë njoftuar nga kjo prokurori, janë duke u zhvilluar një kohë më të gjatë dhe për këtë arsye - avokati Raufi theksoi se beson se kjo prokurori së shpejti do të përfshihet në këtë lëndë, për shkak se edhe ekzistojnë biseda të përgjuara për këtë lëndë. Njëkohësisht, ai nënvizoi se kjo ndoshta mund të jetë arsyeja kryesore se pse Prokuroria për krim të organizuar nuk e ka marrë shumë parasysh këtë lëndë. Mes tjerash, ai shtoi se me kalimin e kohës, në këtë proces gjyqësor do të kërkojnë edhe prezantimin e provave materiale, në këtë rast të veturës “Opel Omega”, e cila sipas tyre, është një dëshmi e orkestruar dhe e cila nuk ka ekzistuar asnjëherë. Krahas mediave dhe opinionit më të gjerë të cilat masovikisht e mbuluan seancën e parë për rigjykimin e rastit “Monstra”, në gjykatë të hënën u paraqiten edhe një numër i konsiderueshëm i familjarëve. Kushëriri i Fejzi dhe Haki Azirit, Bedri Ajdari, pas anulimit të seancës, u shpreh i habitur me faktin se kjo aktakuzë edhe më tutje vazhdon të mbështetet nga Prokuroria për krim të organizuar. “Me udhëzimet të cilat i dha Gjykata e Lartë, unë sinqerisht nuk prisja që kjo aktakuzë e kontestuar të qëndrojë juridikisht. Ne nuk i dimë arsyet se pse Prokuroria e mbështetet përsëri në këtë aktakuzë. Megjithatë, pres që deri në

seancën e radhës të përfshihet edhe PSP në këtë procedurë. Prezantimi i sotëm i këtij prokurori më la përshtypje se PSP së shpejti do ta marrë përsipër këtë rast. Ai në këtë seancë aspak nuk ishte i përgatitur. Informatat tona thonë se kjo lëndë, prokurorit Naum Panovski i është dhënë sot në orët e para të ditës”, theksoi Bedri Ajdari. Ndryshe, vrasja e pesëfishtë në Liqenin e Smilkovës në Shkup ndodhi më 12 prill të vitit 2012, një ditë para festës së madhe krishtere Pashkët. Atë ditë, në rrethana ende të paqarta, në mënyrë brutale janë ekzekutuar të rinjtë Kire Triçkovski, Filip Sllavkovski, Cvetanço Ackovski, Aleksandar Naqevski dhe peshkatari Borçe Stefanovski. Për këtë vrasje, në korrik të vitit 2014, Gjykata Penale e Shkupit me burg të përjetshëm e dënoi Halil Demirin, Afrim dhe Agim Ismailoviqin, Fejzi dhe Haki Azirin dhe Sami Lutën. Ndërkohë, pas shumë reagimeve, protestave dhe vërejtjeve, në fund të tetorit të vitit të kaluar, Gjykata e Lartë e Maqedonisë i shfuqizoi aktgjykimet e shkallës së parë dhe shkallës së dytë për rastin “Monstra”. Kështu që, të gjithë të dënuarit, me përjashtim të të arratisurve Halil Demiri dhe Afrim Ismailoviq, u liruan nga paraburgimi, gjegjësisht të njëjtëve u është shqiptuar masa e kujdesit dhe deri në zbardhje të plotë të rastit ata do të mbrohen në liri. Sidoqoftë, të gjithë të akuzuarit e rastit Monstra, që të hënën u paraqitën në Gjykatë, potencuan dhe apeluan që ky rast të zbardhet sa është e mundur më shpejtë dhe i njëjti rast mos ta ketë trajtim e rastit të “Sopotit”, i cili edhe pas 14 viteve, vazhdon të zvarritet nëpër korridoret e gjykatave.

Evitohet tragjedia, shpëtohen gjashtë skiatorë në Kodrën e Diellit

Tetovë, 12 shkurt - Të dielën mbrëma rreth orës 21 në Kodrën e Diellit janë shpëtuar gjashtë skiatorë, të cilët ishin denoncuar të humbur nga mesdita e ditës së djeshme. Zhdukjen e tyre në Sektorin e policisë Kodra e Diellit e kanë denoncuar 30-vjeçari F.R. nga fshati Lisec i Tetovës dhe M.Z. shtetas nga Kosova. Gjashtë skiatorët, dy nga të cilët kosovarë dhe katër shtetas të Maqedonisë,

rreth orës 14 e 30 minuta me teleferik janë ngjitur në “Ceripashinë” dhe pastaj janë lëshuar përmes shtegut “Jelak”. Por, për shkak të mjegullës së dendur, kanë humbur në një pjesë të panjohur të pyllit, dy kilometra në veri të vendit “Stanet e Shipkovicës” mbi fshatin Veshallë. Menjëherë është organizuar kërkim dhe rreth orës 21 janë gjetur të gjallë dhe shëndoshë në vendin “Studorek” në

afërsi të “Staneve të Shipkovicës”, ndërsa me automjet për pastrimin e borës janë dërguar në Sektorin e policisë “Kodra e Diellit”. Në këtë aksion kanë marrë pjesë pjesëtarë të Policisë, njësitet e zjarrfikësve dhe përfaqësues të Qendrës për menaxhim me kriza. Në Kodrën e Diellit edhe gjatë vikendit ishin humbur dy alpinistë nga Franca, por të njëjtit pas disa orësh ishin gjetur. (U.H)

KRONIKË

Arrestohet tetovarja që keqtrajtonte motrën

Një tetovare gjashtëdhjetëvjeçare L.P mbrëmë në policinë e Tetovës ka denoncuar se motra e saj A.P (62) me të cilën jetën në të njëjtën banesë, psiqikisht e ka maltretuar. MPB informon se tetovarja ka theksuar se motra e saj e ka mbyllur në njërin nga dhomat duke e kërcënuar edhe me jetë, derisa të bijës së saj ia ka mbyllur derën e hyrjes së banesës dhe nuk e ka lejuar të hyjë brenda. A.P është arrestuar dhe mbajtur në SPB Tetovë për procedurë të mëtejme. Për ngjarjen është njoftuar prokurori publik i Tetovës. Kundër A.P. do të ngrihet kallëzim penal përkatës.

40-vjeçari tenton ta përdhunojë 18-vjeçaren

Një dyzetvjeçar D.N. nga Probishtipi dje në Shtip ka kryer përdhunim në tentativë ndaj K.D. (18) nga Shtipi. Siç njoftoi MPB, incidenti ndodhi sot në mëngjes në orën 4:00, pasi që D.N. përmes një mesazhi SMS dhe me kanosje se do të shkojë tek prindërit e saj dhe do t'i krijojë probleme serioze, e ka detyruar shtipjancën që të vijë tek ai. “Ajo ka shkuar tek ai dhe D.N. ka tentuar që me forcë ta detyrojë të jetë marrëdhënie seksuale. Ai e ka përplasur me kokë në mur dhe disa goditje me grushte në pjesën e kokës dhe të trupit, por K.D. ka arritur që të shmanget”, citohet nga MPB. Nga ana e mjekut është kryer vizitë ndaj K.D. dhe u konstatuan edhe lëndime trupore. Ekspertizë në vendin e ngjarjes ka kryer ekipi i SPB të Shtipit. D.N. është arrestuar dhe është mbajtur në SPB Shtip për procedurë të mëtejshme. Pas dokumentimit të plotë të rastit, kundër D.N. do të parashtrohet kallëzim penal për shkak të ekzistimit të bazës së dyshimit për vepër të bërë penale “përdhunim në tentativë”.

Zbulohen 500 gramë marihuanë në një shtëpi në Tetovë

Policia e Tetovës ka gjetur gjysmë kilogramë marihuanë dhe një peshore me mbetje të marihuanës, gjatë bastisjes në shtëpinë e A.R.(30) në Tetovë. Ai është arrestuar në stacionin policor dhe kundër tij do të ngrihet padi penale. “Më 10 shkurt me urdhër të Gjykatës Themelore Tetovë, zyrtarët policorë nga Sektori i Punëve të Brendshme Tetovë kanë kryer bastisje në shtëpinë dhe hapësirën ndihmëse të A.R.(30) në rrugën “Braça Milladinovi” në Tetovë. Gjatë bastisjes, në shumë vende në shtëpi është gjetur drogë narkotike marihuanë me masë të tërësishme prej rreth 500 gr, si dhe një peshore me mbetje të marihuanës. Lëndët e gjetura janë marrë me konfirmimin për lëndë të konfiskuara përkohësisht”, kumtoi MPB. A.R. është arrestuar në stacionin policor dhe pas dokumentimit të tërësishëm të ngjarjes kundër tij do të parashtrohet padi penale për shkak të ekzistimit të bazave të dyshimit për vepër penale të bërë, “prodhimtari të paaautorizuar dhe lëshim në qarkullim të drogave narkotike, substancave psikotropike dhe prekursorë”, i dënueshëm sipas nenit 2015 të Kodit Penal të Republikës së Maqedonisë.

Një e moshuar vdes nga zjarri në Ohër

Një e moshuar ka humbur jetën në një zjarr që e përfshiu të hënën në mëngjes banesën e saj në rrugën “Turistička” në Ohër. Zjarri është raportuar nga fqinjët në orën 7:05 minuta në territorin e njësisë zjarrfikëse, e cila ka intervenuar menjëherë dhe e ka lokalizuar zjarrin dhe ka penguar përhapjen e tij në banesa të tjera të pallatit. Gruaja menjëherë është transportuar në Spitalin e Ohrit, ku u konstatua vdekja e saj. Informacionet e para tregojnë se është një rast aksidental, ndërsa zjarri me siguri u shkaktoi nga një cigare e pashuar. (U.H)

Maqedonishtja do të jetë e obligueshme të mësohet në të paktën tri lëndë, për çdo program studimor në UT, UNT, UEJL, si dhe në universitetet tjera që do të organizojnë studime në gjuhën shqipe nëse nuk ndryshon nenin 132 paragrafi 6 i Propozim-ligjit për arsim të lartë. Në kohën kur në Maqedoni diskutohet zyrtarizmi i plotë i gjuhës shqipe, në nivel shteti, ai nen është sa i panevojshëm, aq edhe anakronik

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 12 shkurt - Propozim-ligji i arsimit të lartë që pritet të nxirret së shpejti, përveçse është i rëndësishëm për frymën dhe rregullimin që do të marrin në të ardhmen institucionet e arsimit të lartë në Maqedoni, është në të njëjtën kohë edhe një test për shqiptarët, respektivisht për institucionet e arsimit të lartë në gjuhën shqipe, si dhe për përfaqësuesit politik në Parlament. Me këtë propozim-ligj, njëjtë si me Ligjin e përparshëm, universitetet në gjuhën shqipe do të duhet të sigurojnë mësimdhënie në gjuhën maqedonase në të paktën tre lëndë për secilin program studimor. Nëse nuk ndodhin ndryshime në pjesën "Gjuhët në të cilat zhvillohet mësimi", pra nëse propozim-ligji miratohet si i tillë, të gjithë studentët e Universitetit të Tetovës (UT), Universitetit të Evropës Juglindore (UEJL), Universitetit "Nënë Tereza" në Shkup, si dhe të universiteteve tjera që mund të organizojnë studime në gjuhën shqipe, do të duhet

NËSE NUK NDRYSHON NENIN 132 I PROPOZIM-LIGJIT PËR ARSIM TË LARTË

UNIVERSITETET SHQIPE ME MINIMUMI TRI LËNDË NË MAQEDONISHT!



që krahas gjuhës maqedonase si lëndë e veçantë - të organizojnë në këtë gjuhë edhe minimumi dy lëndë të tjera. E thënë ndryshe, nga tre lëndë në gjuhën maqedonase do të duhet të ligjërohet në çdo program studimor të universiteteve që nuk janë në gjuhën maqedonase. Propozim-ligji për arsim të lartë në këtë pikë është shumë i qartë. "Kur mësimi zhvillohet në gjuhën e bashkësive etnike të cilët nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë ose në ndonjë prej gjuhëve botërore, në pajtueshmëri me paragrafët 2, 3 dhe 4 të këtij neni, gjuha maqedonase mësohet si lëndë e veçantë mësimore dhe mësimi zhvillohet në gjuhën maqedonase në të paktën edhe dy lëndë mësimore të programit studimor", qëndron në paragrafin 6 të nenit 132 të Propozim-ligjit për arsim të lartë. Në pa-

ragrafin 1 thuhet se "mësimi në institucionet e arsimit të lartë zhvillohet në gjuhën maqedonase", ndërsa në paragrafët pasues (2, 3 dhe 4) shpjegon arsyet përse universitetet mund të organizojnë mësim edhe në gjuhën jomaqedonase. "Pjesëtarët e bashkësive për arsye të shprehjes, kultivimit, dhe zhvillimit të identitetit të tyre dhe veçantive të tjera, kanë të drejtë që mësimin në institucionin publik të arsimit të lartë, sipas programeve studimore dhe përmbajtjeve të përshtatshme, ta realizojnë në gjuhën e bashkësive të ndryshme nga gjuha maqedonase, në përputhje me këtë Ligj dhe me statutin e institucionit të arsimit të lartë. Financimi nga ana e shtetit do të sigurohet për arsimin e lartë edhe në gjuhën që e flasin të paktën 20 për qind e popullsisë së Republikës së Maqedonisë", qën-

dron në paragrafin 2. E drejta e pakicave apo "bashkësive të tjera" për arsim të lartë në gjuhën e tyre përcaktohen në paragrafin 3. "Mësimi në institucionet pedagogjike publike të arsimit të lartë për edukatorë të edukimit parashkollor dhe për mësues të arsimit fillor, si dhe të lëndëve didaktike-metodike për mësimdhënës të shkollave të mesme, mund të realizohet edhe në gjuhët e pjesëtarëve të bashkësive të tjera që nuk janë shumicë në Republikën e Maqedonisë", qëndron aty, ndërsa në paragrafin 4 sqarohet se "në përjashtim të paragrafit 1 të këtij neni, mësimin në institucionet e arsimit të lartë mund të realizohet në ndonjë prej gjuhëve botërore". Propozim-ligji për arsim të lartë numëron ditët e fundit të debatit publik, respektivisht të dhënies së vërejtjeve dhe

propozimeve nga ana e subjekteve juridike, individëve dhe palëve të interesit enkas me tekstin e atij propozimi të publikuar MASH që në fund të dhjetorit. Për shumë çështje është diskutuar në nivel të universiteteve, kurse janë kontestuar shumë pika që kanë të bëjnë me hierarkinë e universiteteve dhe mënyrën e funksionimit të organeve të tij. Por për çështjen e organizimit të minimum tre lëndëve në gjuhën maqedonase, të paktën zyrtarisht nuk është ankuar asnjë prej universiteteve shqiptare, as UT dhe UNT, të cilat duhet ta kenë përgjegjësi morale dhe kombëtare në mbrojtjen e gjuhës shqipe dhe institucionalizimin e plotë të saj në kuadër të institucioneve të veta dhe as UEJL e cila presupozohet që ka një pavarësi më të madhe politike dhe financiare nga shteti se dy të parat. Ende më i panevojshëm dhe anakronik duket kushtëzimi i universitetet me mësim në gjuhën shqipe që të organizojnë mësim në gjuhën maqedonase në të paktën tri lëndë nëse kemi parasysh klimën politike për zyrtarizmin e plotë të gjuhës shqipe në nivel shteti. Do të ndryshohet ose jo nenin 132 i Propozim-ligjit për arsim të lartë, mbetet të presim variantin final të tekstit që do të shkojë në Parlament si dhe veprimet politike të deputeteve viza-vijë këtij neni.

ZVOGËLOHET NUMRI I NXËNËSVE TË SHKOLLAVE TË MESME

PËR KATËR VITE, 15 MIJË NXËNËS MË PAK!

Shkup, 12 shkurt - Numri i nxënësve në arsimin e mesëm është ulur për 15 mijë në periudhën nga viti 2013 deri në vitin 2017, tregojnë të dhënat e Institutit për Hulumtime dhe Edukim Strategjik (IHES). "Ajo që bie në sy që në fillim është se në vitin 2013 në të gjitha vitet - viti i parë, i dytë, i tretë dhe i katër në arsimin e mesëm, ka pasur 85 mijë nxënës, ndërsa në vitin 2017, 70 mijë. Kjo do të thotë se numri i nxënësve është ulur për 15 mijë për vetëm katër vjet", tha Darko Spasevski nga IHES. Trendi i uljes së numrit të nxënësve sipas tij, ka të bëjë në pjesën më të madhe të arsyeve demografike. "Nuk hyjmë shumë në arsyet, por ajo që kemi mundur ta konstatojmë është se duke e pasur parasysh atë që arsimi i mesëm nga viti 2013-2014 është i obligueshëm, arsyeja më e madhe për uljen e numrit të nxënësve janë lëvizjet demografike", thotë Spasevski.



Sipas tij, përveç në Shkup, numri i nxënësve është ulur në të gjitha komunat në Maqedoni. Numri i mësimdhënësve është gjithashtu në ulje, por, siç tha, jo në përqindje të njëjtë si numri i nxënësve. Në periudhën e njëjtë të kuadrit mësimor është ulur prej 7.100 në 7.000 mijë. Kjo, konsideron Spasevski, mund të ardhmen të bëjë problem me numrin e shumtë të mësimdhënësve. Por,

thekson, kjo varet si do të alokohen mësimdhënësit, të cilët në një rast të tillë do të mund të alokohen në mënyrën në të cilën do të sigurojë arsimim më cilësor me paralele më të vogla. Studimi në të cilin janë marrë këto të dhëna dhe që e ka përpunuar Instituti, ka pasur qëllim parimor që të shihet sa në mënyrë transparente shpenzohen mjetet në shkollat e mesme. Ato në bazë të qasjes së

libër deri te informacionet me karakter të qartë është dashur t'i shohin këto të dhëna për nevojat e hulumtimit.

Shkollat e mesme nga 11 komuna fillimisht nuk i kanë dhënë informacionet e nevojshme, ndërsa këtë e kanë bërë madje pasi është ngritur procedura para Komisionit për qasje të lirë deri te informacionet nga karakteri publik. Në kuadër të përgatitjes së studimit, jepen rekomandime deri te shkollat e mesme të tregojnë më shumë transparencë në shpenzimin e mjeteve publike, ndërsa prindërit dhe nxënësit e shkollave të mesme të tregojnë më shumë interes për shpenzimin e mjeteve. Për nevojat e projektit është përpunuar ueb-platforma www.budnooko.mk me përshkrim të hollësishëm të shpenzimeve në shkollat e mesme në baza të ndryshme në periudhën nga viti 2013 deri në vitin 2017.

LAJME SHKURT

Një burrë kafshohet nga një qen në Urën e Gurit

Pesëdhjetëvjeçari D.B. të premtën, rreth orës 7:20, është kafshuar nga një qen-endacak derisa ka lëvizur në Urën e Gurit në Shkup. Siç informon MPB-ja, D.B. është kafshuar në këmbën e djathtë dhe është dërguar në Komplexin e klinikave "Nëna Tereza" për dhënie të ndihmës mjekësore. Ai dje e ka denoncuar rastin në Stacionin policor Qendër.

35-vjeçari gjendet i vdekur në një banesë

Një banor i Gjevgjelisë, 35 vjeçari R.A. të hënën herët në mëngjes është gjetur i vdekur në një banesë në bulevardin "Gjevgjelia". MPB informon se ekspertizë është kryer, ndërsa me urdhër të prokurorit publik, trupi i të vdekurit është dërguar për autopsi.

Fondi Monetar Ndërkombëtar në një raport të titulluar "Infrastruktura Publike në Ballkanin Perëndimor, mundësitë dhe sfidat", thekson se autostradat, hekurudhat, aeroportet, energjia, interneti me bazë të gjerë dhe telefonia janë me performanca 50 për qind më të ulëta se mesatarja e Bashkimit Evropian

Koha Fisnik PASHOLLI

INFRASTRUKTURA NË BALLKANIN PERËNDIMOR



TREG JOFUNKSIONAL RAJONAL DHE GLOBAL

Shkup, 12 shkurt - Të gjitha shtetet e rajonit aktualisht kanë vetëm 30 për qind të të ardhurave të 15 shteteve më të zhvilluara të BE-së. Analizat tregojnë, jo vetëm ngecje në përmirësimin e standardit, por edhe ulje tepër të ngadalshme të hendekut për vetëm 12 për qind, që nga viti 2000 të mirëqenies ndërmjet Evropës dhe Ballkanit.

Zhvillimit ekonomik shumë të ngadalshëm i kontribuon edhe mungesa e infrastrukturës themelore, rrugët apo kapacitetet e vogla për prodhimin e energjisë, si dhe cilësia e ulët e infrastrukturës ekzistuese. Të gjitha shtetet e Ballkanit Perëndimor shënojnë ngecje të madhe në zhvillimin e infrastrukturës së nevojshme për ecjen para të ekonomisë dhe realizimin e investimeve të huaja dhe vendore.

Fondi Monetar Ndërkombëtar në një raport të titulluar "Infrastruktura Publike në Ballkanin Perëndimor, mundësitë dhe sfidat", thekson se autostradat, hekurudhat, aeroportet, energjia, interneti me bazë të gjerë dhe telefonia janë me performanca 50 për qind më të ulët se mesatarja e Bashkimit Evropian.

"Maqedonia, Shqipëria, Kosovë, Bosnje e Hercegovina, Mali i zi dhe Serbia kanë sisteme transportuese, energjetike dhe të telekomunikacionit jo mjaftueshëm të zhvilluara në raport me mesataren e Bashkimit Evropian. Ballkani Perëndimor

ngec ndaj kësaj mesatare kur bëhet fjalë për përkrahjen e zhvillimit ekonomik me infrastrukturë adekuate që vështirësojnë mjaft edhe përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve në këto shtete." Thuhet në analizën e FMN-së.

Mungesa e rrjetit përkatës rrugor kufizon seriozisht edhe lidhjen e prodhuesve dhe konsumatorëve me tregun rajonal dhe global. Analiza më tej thekson se kordinimi rajonal i aktivitetëve më intensive në avancimin e infrastrukturës publike së bashku me menaxhimin më të mirë të vetë projekteve do të rrisin Prodhimin e Brendshëm Bruto për kokë banori për tre deri katër për qind. Por, zënia e hapit me nivelet e infrastrukturës së BE-së është e vështirë: investimet publike kërkojnë burime të mjaftueshme buxhetore dhe korniza të forta institucionale që rregullojnë përzgjedhjen, ekzekutimin dhe monitorimin e projekteve. Këto dy kushte kryesisht mungojnë në Ballkanin Perëndimor. Shumica e vendeve në rajon tashmë kanë nivele të larta të borxhit publik dhe disa gjithashtu kanë deficite të larta buxhetore apo më shumë harxhojnë para se sa hyjnë para nga të ardhurat e ndryshme të shtetit.

Vlerësohet se financimi i infrastrukturës në Ballkanin perëndimor duhet më shumë të mbështetet në financimin e jashtëm, ndërsa resurset vendore duhet të shfrytëzohen

për kreditimin e sektorit privat. Gjithashtu shtetet e rajonit me borxh të lartë publik duhet të koncentrohen në donacione, dhe financime bilaterale dhe multilaterale në bazë të koncesioneve.

Gjithashtu, rekomandohet ruajtja e stabilitetit makroekonomik duke bërë kompromise ndërmjet rritjes ekonomike, inflacionit dhe deficiteve të jashtme të llogarive rrjedhëse apo borxheve të shtetit që mund të rrezikojnë stabilitetin ekonomik.

Pra, shtetet duhet të kenë kujdes që me projekte tejet ambicioze ose të dobëta të infrastrukturës publike, të mos rrezikojnë stabilitetet e tyre të përgjithshme makroekonomike, që me fjalë të tjera do të thotë një vëmendje më e madhe ndaj mbajtjes nën kontroll të borxhit publik dhe kursit të valutave vendore dhe uljes së deficitit buxhetor.

FMN rekomandon përfundimin e kapaciteteve për planifikimin dhe realizimin e projekteve, mospolitizimin e projekteve dhe përmirësimin e koordinimit rajonal për shkak se mjaft akse rrugore kanë karakter rajonal, zgjerimin e bazës së tatimpaguesve.

Në ndërkohë në Maqedoni në dhjetë vitet e kaluara asnjëherë nuk janë realizuar investimet kapitale në vlerën prej 100 për qind sa janë planifikuar në buxhet në fillim të vitit. Shumat e planifikuara si rën-

dom janë shkurtuar me rishikime të buxhetit ku për shkak të mungesës së parave në arkën shtetërore, ose të hyrave më të vogla buxhetore, të parat që shkurtohen me gërshtëri kanë qenë investimet kapitale. Bile edhe shumat e shkurtuara nga rishikimi i buxhetit shpesh nuk janë realizuar në tërësi. Ekonomistët thonë se investime kapitale sjellin zhvillim më të madh ekonomik, krijojnë parakushte për inkurajime të investimeve të huaja dhe investimeve të brendshme. Bile nëse llogariten shumat që nuk janë investuar si investime kapitale në dhjetë vitet e fundit, del se afër 900 milionë euro nuk janë realizuar tërësisht.

Nga ana tjetër, edhe një pjesë e caktuar e investimeve kapitale nuk kanë sjellë efekt shtesë dhe afatgjatë për ekonominë për, shkak se janë investuar në projekte joproduktive siç ishte "Shkupi 2014".

Megjithatë institucionet e ndryshme ndërkombëtare financiare sugjerojnë që shtetet në zhvillim të rrisin të fondet për projekte të ndryshme infrastrukturore, dhe të reduktojnë gradualisht qarkullimet për paga, pensione, mallra dhe shërbime. Sipas rekomandimeve të Bankës Botërore, shtetet në zhvillim duhet të ndajnë së paku 20 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto apo afër 1.8 miliardë euro në rastin e Maqedonisë, e cila ndan më pak se 5 për qind të PBB-së për investime kapitale.



Biznesi kërkon vërejtje dhe jo gjoba

Shkup, 12 shkurt - Ndryshimi i politikës ndëshkuese me intervenime të Ligji për kundërvajtje, zbatim më i shpeshtë i vërejtjeve, ulj të gjobave, heqje të urdhërpagesës mandatë dhe rregullim të kundërvajtjes si opsion që jep mundësi për ankesë dhe gjobë më të ulët, kërkoi të hënën Grupacioni i shpeditoreve dhe operatorëve logjistikë pranë Odës Ekonomike të Maqedonisë. Konsiderojnë se gjatë përcaktimit të lartësisë së gjobës duhet të merret parasysh edhe pesha edhe natyra e kundërvajtjes së kryer, shkalla e përgjegjësisë së kryerësit dhe rrethanat e tjera nën të cilat është kryer. Tani gjoba përcaktohet vetëm nga performancat e firmës, siç është lartësia e të ardhurave, numri i përgjithshëm i të punësuarve dhe nëse paraprakisht janë shqiptuar sanksionet kundërvajtëse.

"Kërkojmë të ulet shumata maksimale e deritanishme e lartësisë së gjobës që tani është 5.000 euro, si dhe të shfuqizohen nenet e tjera të Ligjit ndërsa me të cilat vlera maksimale bie në ujë dhe është e lejuar me një nen tjetër që ajo shumë të jetë disa herë më e madhe", tha në konferencën për shtyp Gjino Shkrijev, kryetar i Grupacionit të shpeditoreve dhe operatorëve logjistikë. Tatjana Shterjova nga Oda Ekonomike e Maqedonisë, nënvizoi se Ligji i tanishëm për kundërvajtje rregullon se gjoba për person juridik mund të shqiptohet në vlerë mes 200 dhe 5.000 euro, por njëkohësisht rregullon dhe se për shembull me Ligjin për dogana gjoba e përcaktuar maksimale do të jetë 15.000 euro, ndërsa me Ligjin për ujëra edhe deri 20.000 euro. Nga Grupacioni kërkojnë edhe të rishqyrtohen modalitetet si janë rregulluar procedurat për rrafshim, veçanërisht të urdhërpagesa mandatë ku nuk ka të drejtë ankese. Ndryshimet në Ligjin për kundërvajtje duhet të përfshihen me strategjinë për reforma në sistemin gjyqësor

TAV do të investojë edhe 45 milionë euro

Shkup, 12 shkurt - Janë konfirmuar prioritetet për investimin prej 45 milionë euro në Maqedoni të TAV-it në pajtim me marrëveshjen për koncesion për aeroportet e Maqedonisë, në takimin e së hënës të kryeministrit të Maqedonisë, Zoran Zaev me përfaqësues të Grupacionit të TAV-it, menaxherit kryesor, Mustafa San Shener, zëvendësmenaxherit, Alp Er Tunga Ersoj.

Paratë do të investohen në projekte të rëndësishme për qytetarët e shtetit tonë, bëri të ditur pas takimit pres shërbimi qeveritar.



"Bëhet fjalë për investime në kopshte, shkolla, rrjetet kulluese dhe kanalizimit dhe rrugë lokale dhe rajonale, kjo që realisht u nevojitet qytetarëve tanë. Sinqerisht

jam i kënaqur që nga ky investim dobi të drejtpërdrejtë do të ndjejnë qytetarët e Republikës së Maqedonisë", ka thënë në takim kryeministri Zaev, i cili prej dje po

qëndron për vizitë në Turqi. Përfaqësuesit e TAV-it kanë theksuar se ka marrëveshje dhe se me kënaqësi do ta realizojnë, njëkohësisht duke shfaqur falënderim për bashkëpunimin e mirë me kryeministrin dhe Qeverinë e re dhe mbështetje në përpjekjet për zhvillimin e vendit.

Kryeministri Zaev dhe delegacioni i Maqedonisë pas takimit me përfaqësuesit e TAV-it e vizituan e Mauzoleun e Mustafa Kemal Ataturkut, ku vendi kurorë lulësh dhe u nënshkrua në Librin e përkujtimeve.

BUXHETI 2018 I MINISTRISËSË KULTURËS

NDËSHKIMI I RADHËS PËR TEATROT SHQIPTAR

Shumat me të cilat Ministria e Kulturës do të mbështesë Programin vjetor të institucioneve të kulturës, manifestimeve kulturore, projekteve alternative e të tjera - në sferën e aktivitetit dramatik ka shkaktuar reagime negative brenda komunitetit artistik. Buxhetet e reduktuara nga 40 deri në 70 për qind krahasuar me vite të kaluara, por edhe disa herë më të vogla nga ato të planifikuara, nuk kanë sjellë asnjë ndryshim pozitiv në mbështetjen e veprimtarisë artistike dhe promovimin jashtë vendit

Koha

Evis HALILI

Shkup, 12 shkurt - Programi vjetor për mbështetjen e projekteve në kulturë është cilësuar nga ministri Robert Allagjovovski si një mbështetje e fuqishme për kulturën dhe që mundëson ndërtimin e një shoqërie, decentralizimin e kulturës dhe akses të barabartë për të gjithë. Por shumat me të cilat Ministria e Kulturës do të mbështesë Programin vjetor të institucioneve të kulturës, manifestimeve kulturore, projekteve alternative e të tjera - në sferën e aktivitetit dramatik ka shkaktuar reagime negative brenda komunitetit artistik. Buxhetet e reduktuara nga 40 deri në 70 për qind krahasuar me vite të kaluara, por edhe disa herë më të vogla nga ato të planifikuara, nuk kanë sjellë asnjë ndryshim pozitiv në mbështetjen e veprimtarisë artistike dhe promovimin jashtë vendit.



Përveç kushteve në të cilat prej disa vitesh funksionon Teatri Shqiptar në Shkup, Teatri i Tetovës, Sektori i Dramës në Kumanovë, e të tjera, vendimi për financimin e programit të tyre vjetor me shumta të vogla ka konsoliduar kontinuitetin e vendimeve të mëparshme të financimit minimal të teatrove shqiptare. E njëjta gjë ka ndodhur edhe me festivalet teatrore. Me përjashtim të Festivalit të Teatrove të Teatrit të Tetovës, që ka një buxhet prej dy milionë denarë, festivalet e tjera si ai i Dibrës, "Skupi Fest", kanë përfituar minimumet e mundshme të financimit. Teatri Shqiptar i Shkupit këtë vit ka përfituar vetëm 5 milionë denarë, nga 9 milionë të parashikuara për realizimin e tre shfaqjeve. Drejtori Adem Karaga kërkon nga Ministria e Kulturës që të rishikojë vendimin dhe buxhetin që është i njëjtë me atë të viteve të kaluara, pasi këtë vit duhet të investohet më shumë në produksionin e vet.

"Për shkak të funksionimit tonë 'nomad' në katër vitet e kaluara, në të cilat edhe ansambli edhe publiku i Teatrit Shqiptar pësoi dëme, si imeprativ të Programit të vitit 2018 parapamë dhe kërkuam, pos projektit të hapjes, kushte për rimëkëmbje të dinjitetit të institucionit tonë, duke filluar nga produksioni i pasur me autorë të verifikuar për vlera të larta artistike, në të cilin do të përfshihen sa më shumë aktorë nga ansambli ynë, të shoqëruara edhe me një fushatë

agresive mediatike për rikthimin e publikut në Teatrin tonë, si dhe kushte të tjera të munguara prej kohësh", thotë drejtori Adem Karaga.

Ndërsa mbështetja që i jepet për prezantimet jashtë vendit është shumë e vogël, duke mos marrë parasysh çmimet që fitoi ky institucion gjatë vitit të kaluar në festivalet jashtë Maqedonisë, duke vënë kështu në pikëpyetje prezantimin gjatë këtij viti.

"Rezultatet e konkursit për bashkëpunim ndërkombëtar janë shumë konfuze. Për shembull, për udhëtim në Turqi - një teatri i janë ndarë mbi 1 milion denarë, një tjetri 800 mijë denarë, ndërsa neve 500 mijë denarë... Me buxhetin e vitit 2018 për këto festivale nuk e di sa do të mund t'ia dalim apo në sa prej tyre do të mund të prezantohemi", shton Karaga. Dy prej festivaleve më tradicionale të teatrit, Festival i Dibrës dhe "Skupi Fest" po ashtu kanë marrë mbështetje minimale. Nëse për shkak të një gabimi teknik, siç sqarojnë në Ministrinë e Kulturës, Festivali Teatror i Dibrës nuk figuronte në listë, "Skupi Fest" ka marrë vetëm një milion denarë ose tre milionë më pak sesa festivali tjetër i ngjashëm me të - THR.

"Ky vendim është skandaloz dhe reduktim drastik i buxhetit të këtij festivali që përfaqëson brendin e vetëm mbarëshqiptar të festivaleve ndërkombëtare, duke bërë që ky vendim të jetë politik

dhe jokulturore, i inateve të vogla dhe meskine. Besojmë se ky vendim është i tillë, pasi shkurtimi 200 për qind i buxhetit ka qenë arbitrar dhe nuk është arsyetuar prej tyre", thotë drejtori i "Skupi Fest", Muzbajdin Qamili. Edhe Festival i Teatrit të Dibrës nuk do të marrë më shumë se 400 mijë denarë. Në Ministrinë e Kulturës, në Komisionin për veprimtarinë dramatike pohojnë se ka shumë padrejtësi dhe të meta në financimin e projekteve shqiptare. Anëtari Hamdi Rashidi edhe pse thotë se nga 80 milionë denarë - rreth 23 për qind (rreth 18 milionë denarë) janë për projektet shqiptare, por kjo shumë mbetet e pamjaftueshme për disa institucione, projekte, e të tjera.

"Kemi pasur mbi 37 projekte prej të cilave janë miratuar 20. Pjesa më e madhe janë mbështetur me shumta të vogla, por kjo është situata. Vetë buxheti për veprimtarinë dramatike ka qenë më i vogël për tre milionë denarë nga njëra anë, por ka edhe shumë padrejtësi, nga ana tjetër. Unë jam i vetëdijshëm se për Teatrin Shqiptar 5 milionë janë pak, apo se për 'Skupi Festin' është bërë padrejtësi, por vendimet finale i sjell ministri dhe jo Komisioni", thotë Rashidi.

Projektet e tjera alternative, si festivalet në Kërçovë, Gostivar, Kumanovë, Dibër, Strugë edhe këtë vit do të mbështeten me shumta të vogla nga 200 e deri në 400 mijë denarë.



HAMDI RASHIDI

Vetë buxheti për veprimtarinë dramatike ka qenë më i vogël për tre milionë denarë nga njëra anë, por ka edhe shumë padrejtësi, nga ana tjetër. Unë jam i vetëdijshëm se për Teatrin Shqiptar 5 milionë janë pak, apo se për 'Skupi Festin' është bërë padrejtësi, por vendimet finale i sjell ministri dhe jo Komisioni



MUZBAJDIN QAMILI

Ky vendim është skandaloz dhe reduktim drastik i buxhetit të këtij festivali që përfaqëson brendin e vetëm mbarëshqiptar të festivaleve ndërkombëtare, duke bërë që ky vendim të jetë politik dhe jokulturore, i inateve të vogla dhe meskine. Besojmë se ky vendim është i tillë, pasi shkurtimi 200 për qind i buxhetit ka qenë arbitrar dhe nuk është arsyetuar prej tyre



ADEM KARAGA

Rezultatet e konkursit për bashkëpunim ndërkombëtar janë shumë konfuze. Për shembull, për udhëtim në Turqi - një teatri i janë ndarë mbi 1 milion denarë, një tjetri 800 mijë denarë, ndërsa neve 500 mijë denarë... Me buxhetin e vitit 2018 për këto festivale nuk e di sa do të mund t'ia dalim apo në sa prej tyre do të mund të prezantohemi

Reagim nga Shtëpia Botuese "VATRA"

Kur t'i hedhësh një sy Programit të sivjetshëm botues, rezultateve të shpallura nga ky program i Ministrisë së Kulturës, do të vërehet se ndarja e mjeteve për këtë veprimtari ngjan sikur, shumë vite më parë, në varfëri të skajshme, sidomos nëpër fshatra, nëpër dasma, hyzmetçiu që ua ndante me lugë druri hallvën fëmijëve, më parë ua mbu-

shte këmishat e xhepat fëmijëve të fafesisit..., bajraktarëve të katundit e mandej të tjerëve... ose, ngjashëm me këtë, në ditët e sotme i ngjan një kocke në duart e anëtarit të Komisionit që e hedh ku do ai vetë, atyre që i ka pranë vetes dhe disa të tjerë që vrapojnë të lëpohen nga pak. Pyetjes tuaj a jam i kënaqur me rezultatet e shpallura të SHB-së

"VATRA" do t'ju përgjigjem se, në shikim të parë, PO. Mirëpo, kur do ta analizosh më detajisht, do të konstatojmë se projektet botuese nga Komisioni janë shqyrtuar shkel e shko, pa kurrfarë kriteresh e profesionalizmi. Si mundet një projekt botues, përkatësisht një botim me 250 faqe, të financohet me 50.000 denarë! Ajo që është më skandaloz,

ze, revista për Kulturë, Art e Shkencë "JEHONA E RE" që botohet në kuadër të SHB-së "VATRA", me Këshill botues të përbërë nga emra të shquar të kulturës e shkencës, akademikë e profesorë universitarë, një revistë ndoshta e vetmja elitare, e cila me vite (18 vjet) botohet nga disa numra në vit, si vazhdimësi e revistës Jehona që 40 botohej në

kuadër të gazetës Flakës, TË MOS FINANCOHET! Aq më tepër kur me këtë revistë bashkëpunojnë emra të shquar nga lëmi i kulturës, artit e shkencës, shkrimtarë të njohur, përkthyes, kritikë letrare, materiale nga literaria botërore etj! Kjo le të kuptosh se anëtarët e Komisionit janë injorantë nga fusha e kulturës, e letërsisë, shkencës artit, etj.

ARBEN TARAVARI PREZANTON PUNËN PËR 100 DITËT E QEVERISJES

"PAGUAM MBI 300 MIJË EURO BORXHE"

"Për vetëm 100 ditë, duke racionalizuar skajshmërisht shpenzimet joproductive, kemi arritur të paguajmë mbi 300 mijë euro borxhe të trashëguara. Te transporti i nxënësve, duke mos favorizuar kompani përkatëse, arritëm që të kursejmë 250 mijë euro për një vit, mjete këto të cilat do t'i shfrytëzojmë për investime për përmirësimin e kushteve nëpër shkollat publike", tha Taravari



Koha

Urim HASIPI

Gostivar, 12 shkurt - Arben Taravari, kryetari i Komunës së Gostivarit, të hënën i prezantoi të arriturat e udhëheqësisë së re komunale për 100 ditët e para të mandatit 2017-2021. Si të arritura më të mëdha, i përmendi shlyerjen e borxheve dhe ndikimin e politikës në sferën e arsimit.

"E depolitizuar arsimin duke bërë emërimet të drejtorëve kryesisht të propozuar nga vetë kolektivet e shkollave. Kuadrin arsimor joadekuat e zëvendësuam me kuadër të profilit të caktuar. E depolitizuar, po ashtu, edhe Këshillin Rinor të komunës së Gostivarit, pa mos ndikuar fare në zgjedhjen e kryesisë. Për vetëm 100 ditë, duke racionalizuar skajshmërisht shpenzimet joproductive, kemi arritur të paguajmë mbi 300 mijë euro borxhe të trashëguara. Te transporti i nxënësve, duke mos favorizuar kompani përkatëse, arritëm që të kursejmë 250 mijë euro për

një vit, mjete këto të cilat do t'i shfrytëzojmë për investime për përmirësimin e kushteve nëpër shkollat publike", tha Taravari në konferencën për shtyp. Ai theksoi se me mbështetjen e donatorëve dhe biznesmenëve nga Gostivari, është gjetur zgjidhje e përkohshme e problemit me çatinë e shkollës "Goce Dellçev", ndërsa në një të ardhme të afërt, problemin do ta zgjidhin për afat të gjatë. Taravari pret që këtë pranverë të vendoset në funksion edhe filtër stacion për ujë të pijshëm, ndërsa nënvizoi edhe se me ndihmën e Ambasadës së Zvicrës të fillojnë punimet në deponinë Rusino për çka është nënshkruar edhe memorandum me nëntë komuna të Pollogut. Kryetari i komunës paralajmëroi

edhe ndryshime në mënyrën e ndriçimit publik, ndërsa u lavdërua edhe me riorganizimin e administratës dhe efekte të rritura nga kjo. "Formuam ekipin e protokollit dhe marrëdhënieve me publikun, me qëllim që të rrisim transparencën dhe lehtësuam qasjen e lirë deri te informatat me karakter publik. Për herë të parë në komunën e Gostivarit u organizua prezantim i propozim-buxhetit para qytetarëve dhe u debatua mbi të njëjtin. Rritëm të hyrat nga tatimet për rreth 20 për qind në muajin janar të vitit 2018, krahasuar me muajin e njëjtë të vitit të kaluar 2017. Kjo flet se është rritur besueshmëria e qytetarëve në institucionin komunë", tha Taravari. Në prezantimin për "100 ditët

punë", Taravari i përmendi edhe takimet dhe kontaktet me shumë biznesmenë dhe investues potencialë nga vendi dhe jashtë, me ç'rast është shprehur gatishmëria që t'u ofrohen atyre favore infrastrukturore me qëllim që ata të investojnë në komunën e Gostivarit. "Kemi realizuar takime të shumta me ambasadorë, si në komunën e Gostivarit, ashtu edhe në selitë e ambasadave. Realizuar takim edhe me kryetarët e dy kryeqyteteve shqiptare Tiranës dhe Prishtinës, gjegjësisht me z. Erion Veliaj dhe z. Shpend Ahmeti", potencoi ai. Në fund të prezantimit, Taravari informoi se Komuna e Gostivarit ka fituar grand nga UNDP dhe Bashkimi Evropian në vlerë prej 120 mijë euro.

Bllokohet Malina, Breza dhe Tanusha

Shkup, 12 shkurt - Aksi rrugor i cili të çon në fshatrat Malinë, Brezë dhe Tanushë në komunën Çuçer Sandevë nga vikendi është bllokuar për shkak të reshjeve të dëborës, informojnë Qendra për Menaxhim me Krizat e Qytetit të Shkupit. Momentalisht të gjitha tre fshatrat kanë energji elektrike dhe do të dërgohen ekipe në terren. Çdo vit kur do të bjerë dëborë, këto janë fshatrat e para që bllokohen në rajonin e Shkupit.

Rritet numri i turistëve

Shkup, 12 shkurt - Maqedoninë vitin e kaluar në dhjetor e kanë vizituar 51.599 turistë, të cilët kanë realizuar 103.721 bujtje, që paraqet për 22.6 për qind më shumë turistë dhe për 28 për qind më shumë bujtje në krahasim me muajin e njëjtë të vitit të kaluar. Sipas të dhënave të Entit Shtetëror të Statistikës, në dhjetor të vitit 2017 numri i turistëve vendas është rritur me 19 për qind, ndërsa i të huajve për 24.7 për qind. Numri i bujtjeve të turistëve vendas është rritur për 29.3 për qind, ndërsa i turistëve të huaj për 27 për qind. Numri i turistëve në vitin 2017 është rritur për 16.6 për qind në krahasim me vitin 2016, me ç'rast tek turistët vendas ka rritje për 6.3, ndërsa tek të huajt për 23.5 për qind. Numri i bujtjeve është rritur për 12.8 për qind. Tek turistët vendas ka rritje për 5.2, ndërsa tek të huajt për 22.8 për qind.

Në dhjetor u miratuan 257 leje ndërtimi

Shkup, 12 shkurt - Vitin e kaluar në dhjetor në vend janë lëshuar 257 leje ndërtimi me vlerë të parashikuar të objekteve prej 1.73 miliardë denarëve, që është për 22.8 për qind më pak leje në krahasim

me muajin e njëjtë të vitit të kaluar dhe për 76.7 për qind më pak vlerë. Me këto është parashikuar ndërtimi i 209 apartamenteve, me sipërfaqe të përgjithshme të dobishme prej 25.413 metra katrorë. Sipas të dhë-

nave të Entit Shtetëror të Statistikës, nga numri i përgjithshëm i lejeve të ndërtimit të lëshuara, 155 (60.3 për qind) janë dedikuar për objekte të ndërtimeve të larta, 19 (7.4 për qind) për objekte të ndërtimeve të ulëta,

ndërsa 83 (32.3 për qind) për objekte për rindërtim. Nga gjithsej 257 objekte, 184 ose 71.6 për qind e investuesve paraqiten persona fizikë, ndërsa 73, gjegjësisht 28.4 për qind janë subjekte afariste.

Muajin e ardhshëm konkurs për shpërndarje të 79 banesave sociale

Shkup, 12 shkurt - Ministria e Transportit dhe Lidhjeve muajin e ardhshëm do të shpallë konkurs për shpërndarjen e 79 banesave sociale nëpër disa qytete të vendit prej të cilave 59 janë për persona në rrezik social dhe 20 për persona me të ardhura të ulëta. "Më me rëndësi për ne është procedura e cila do të zhvillohet, të jetë maksimalisht transparente. Pohoj se nuk do të lejojmë të ndodhin kurrfarë manipulimesh me qëllim që kategorive më të ndjeshme të qytetarëve Ministria e Transportit dhe Lidhjeve dhe Qeveria t'u ndihmojnë ta zgjidhin çështjen banesore", deklaroi ministri i Transportit dhe Lidhjeve, Go-



ran Sugarevski. Nga 59 banesat dedikuar për persona në rrezik social, 39 janë në Koçan, ndërsa 10

në Makedonski Brod, dhe për ta për herë të parë po bëhet ndarja, ndërsa sipas asaj baze do të

ndahen edhe tre në Prilep, nga dy në Shtip, Berovë dhe Kriva Pallankë dhe një në Kërçovë të cilat janë të lira në baza të ndryshme. Në pajtim me analizën e Ministrisë së resorit dhe NP për ekonomizim me hapësirë banesore dhe afariste, për persona me të ardhura të ulëta ka shtatë banesa të lira në Veles, nga tre në Kratovë dhe Koçan, dy në Prilep dhe nga një banesë në Kriva Pallankë, Dibër, Tetovë, Gostivar dhe Shtip. Për shpërndarjen e banesave do të formohet komisioni i posaçëm i cili do t'i shqyrtojë të gjitha paraqitjet. Banesat për persona në rrezik social të cilët do t'i përfshijnë kategoritë fëmijë pa prindër apo

kujdes prindëror, shfrytëzues të ndihmës sociale apo ndihmës së përhershme në të holla, persona të goditur nga fatkeqësitë elementare, persona invalidë dhe persona të cilëve u nevojitet ndihmë dhe kujdes nga një person tjetër, pjesëtarë të bashkësisë romë të cilët janë në rrezik social, prindër kryefamiljarë me fëmijë të mitur, si dhe persona të verbër, shfrytëzues të ndihmës sociale apo ndihmës së përhershme në të holla. Siç paralajmëroi paraprakisht Sugarevski, në periudhën në vijim është planifikuar ndërtimi i 467 banesave sociale në Shkup, Pehçevë, Sveti Nikole, Vinicë dhe Probishtip.

Politika shqiptare "mbytet" në detin Jon



Behar GJOKA

Temë e ditës, prej kaq kohësh, e shoqëruar me mllef, sharje, mashtrime dhe hipokrizi, të vërteta dhe hipoteza, është tema e Detit, që shitet dhe blihet, sa herë ka nevojë politika. Qeveria, me gjithë faktorët e vetë, ku veçohet "heshtja" diplomatike e ministrit të përjashtëm, dhe "ligjërimi" më i qartë i Kryeminsitrit, që ngre siparin e bisedimeve të zhvilluara për marrëveshjen e re për detin. Në anën tjetër, në Greqi, zyrtarët dhe media, uluret dhe gëzohet se po arrihet një marrëveshje historike me Shqipërinë për detin. Ndërsa opozita, e zënë me punëra më të rëndësishme (nuk di a ka temë më të madhe se sa cënimi i territorit), hesht dhe ka marrë kodrat dhe malet, për zullumet e shumta që ka kryer dhe po kryen secilën ditë mazhorancës. Jo për të qenë të qartë, se as ata që e kanë kavërditur këtë "çorbë", politika shqiptare e gjithë krahëve, nuk e dinë se çfarë gjelle është, por vetëmsa po shprehemi, për situatën e mungesës e transparencës, përmbi këtë temë, më përtej fasadës që deklarohet në "kazanin" mediatik. Urojmë që të mos jetë "çorbë" që ka lidhje me kallaisjen e tepsisë së pushtetit! Po kaq, ne si popull, trim e mendar, pas betjes dhe kuvendit, të zënë me hallet tona, të indiferencës, deri në fikje, të opinionit qytetar, për këtë çështje të një ndjeshmërie, që nuk ka pronar dhe kumandar, presim se mos pikërron zgjidhja prej qiellit. Atdheu dhe kombi nuk ka pronar, sepse hipotekat e tyre, janë në mendjen dhe zemrën e bashkëkombasve, që janë mbytur në varfëri dhe dëshpërimin se ky vend nuk bëhet, që të mos ia hamë hakën, politika ka merita të veçanta, për të mendura, ikjen nga sytë-këmbët. Politika dhe qeveria, të zënuar me etheet e mbajtjes dhe marrjes së pushtetit, aq më tepër që janë vetë "guzhinier" të këtij bagërdani, mermërisin me vete, të gremisur në etheet e politikës së ditës. Pse hesht opozita? E dimë përgjigjen, por vetëmsa për kujtesë, po themi se në vitin 2009 kur qe në pushtet, negocioi për detin me grekët, në bazë të parimi të 6 miljeve! Me të drejtë, pozita e sotme, dje në opozitë, lëshoi alarmin, e dërgoi në gjykatën kushtetuese. Dhe nuk u arrit marrëveshja, deti nuk u bë pazar, për hir të pushtetit. Pse flet pozita me kaq siguri? Pasi është endur "politika e zero problemeve" me fqinjët, ndërkohë që ata kanë shumë, madje oreksi i tyre vjen duke

ngrënë, orë e çast. Kërkesat e tyre, vetëmsa do të shtohen, sikur të negociohet edhe për bregdetin. Rimarrja e negociatave të detit, madje po flitet për një marrëveshje historike të marrëdhënies, e cila po duket në horizont, në mos janë në proces, në mos janë bërë gati për firmë. Parimi i propozuar nga qeveria është më 12 milje! Pra, për 6 milje, në 2009 ishte tradhëti, e për 12 milje, tani në 2018, është diplomaci dhe mençuri! Merifetet e politikës, për të folur me shifra, sa kanë për borxh, të bëjnë detin e kos, e kosin lum për hidrocentrale, në këtë Shqipërinë tonë halleshumë, nuk paskan të sorsur. Mjeshtria e fshehjes së mendimit prapa teknikaliteteve, që as vetë nuk i marrin vesh, krijoi tymnajë dhe kakofoni, përgjigjesh dhe mermërimash, e deti ngre valët, si për ditë dimri, pak më lartuar se në zhegun e vapës. Shifrat, janë si gjethe fiku, për të mbuluar, pikësynimet e qarta politike, vetëm që të garantohet vota e Greqisë, për hapjen e negociatave. Edhe në 2009, ku flitej për detin, në qendër të vëmendjes së pushtetit, ishte vota për të hapur negociatat me Europën. Në vend të

parimit "Zero" duhej marrë në konsideratë parimi i reciprocitetit dhe fqinjësisë së mirë. Jo për hir të politikës, po për hir të dinjitetit njerëzor, duhet të bëhet e ditur, çfarë u bisedua dhe çfarë është vendosur. Të negociosh për detin, vetëm për të marrë votën greke për të hapur negociatat, formalisht duket në rregull, por harrohet se dikush tjetër, vë vetonë për "detyrat e shtëpisë" të lëna me kohë, për politikanët shqiptarë, e përsëri mbetemi me gisht në gojë. Nëse bie ligji i luftës, një ligj që mbahet në këmbë, prej luftës Italo-greke, të zhvilluar në trojet shqiptare, ku shqiptarët, herë me njërin, e herë me tjetrin, janë vetë viktima të asaj lufte. Të negociosh për detin, vetëm për këtë ligj, që tregon atavizmin e politikës së fqinjët jugor, është lëshim, për nevojën që duhet të bëhen transparente. Të negociosh për detin, dhe të vijosh politikën e lëshimeve të Berishës për varrezat greke, madje duke shkuar më tej, në emërtimin e tyre, si Varreza Historike, e kapërcen logjikën formale. Të negociosh për detin dhe të harrosh çështjen çame, nuk i gjendet emri. Pavarësisht lëshimeve për detin,

Të negociosh për detin, vetëm për të marrë votën greke për të hapur negociatat, formalisht duket në rregull, por harrohet se dikush tjetër, vë vetonë për "detyrat e shtëpisë" të lëna me kohë, për politikanët shqiptarë, e përsëri mbetemi me gisht në gojë.



presidenti i fqinjët jugor, lëshon tymuese, sikur po flet me komunarët e shtetit të vetë... Çamëria ende kulon gjak, gjë që e dinë edhe zyrtarët grekë, por u lëvdisë që ta lënë në shurdhëri dhe memecëri. Të jetë e qartë për ne si shqiptarë, për politikën dhe çdo politikanë shqiptarë, se nuk ka det që ta lajë padrejtësinë e kryer mbi banorët e Çamërisë. As varret e të parëve nuk kanë të drejtë t'i shohin! Flet pozita, krejt e sigurtë, sepse gjykata kushtetuese, nuk ka mundësi të mblidhet, e prandaj politika shqiptare, pozitë dhe opozitë, në heshtje, e kryen misionin, i dhanë të drejtën e ndarjes së detit, duke fituar një ligj, nëse do të ndodh realisht, që nuk ka të bëjë me qytetërimin grek të lashëtësisë. Nuk duhet harruar porosia e Faik Konicës: Grekët kanë një armë të frikshme: pabesinë (Albania 2, 1897), kur ulesh në bisedime me to. Nuk është e keqja të marrëveshja për detin, por te ngulmimi që për të marrë votën për hapjen e negociatave, politika shqiptare, më tepër po kridhet në ujë, e Deti Jon është i thellë, e po u zhyte "mbytesh" në valët e tij, e nuk mbërrin të mbulosh paaftësinë e politikës.

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Ratkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovashja lok.14 - përdhësë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e hënë 12 shkurt | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Redaktor përgjegjës: Emin AZEMI | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3179 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribim: Afrim DULLLOVI - Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772



Koha, e martë 13 shkurt, 2018

Kur do të heqim dorë nga metoda e konkurseve dhe përdorimit të termit “Elitar” apo “Koncerte Gala” për fëmijë, teksa pretendojmë se fëmijëve të shkollave 9-vjeçare po u ofrojmë projekte quasi edukues, përmes muzikës, artit, apo kulturës në Shqipëri? “Miti i talentit dhe Elitaria” është një nocion i gabuar dhe krejtësisht i pavend, sa kohë që fëmijët duam t’i edukojmë pa asnjë dallim, përmes artit dhe kulturës!

Nga Eda Zari

Para pak ditësh në Instagram lexoj: “(...) TKOB shpall një kalendar dedikuar edukimit përmes Artit si prioritet i këtij viti artistik...”. Dhe pastaj: “(...) ky projekt elitar mundësohet për herë të parë duke bërë bashkë 50 fëmijë të dalë nga konkursi Eja këndo me ne!”

Fillimisht e përgëzoj këtë iniciativë. Fëmijët mësojnë nga përvojat e ofruara nga një dorë e ngrohtë profesioniste, e ndoshta një pjesë e artistëve janë vetë prindër. Përforsimi pozitiv nga ana e të rriturve i motivon fëmijët. Po kështu, një qëndrim prindëror edukues (sepse të gjithë fëmijët duhen njësoj), u fal atyre besimin dhe nxit dëshirën e tyre për t’u artikulluar muzikalisht më tej.

Të tilla iniciativa e projekte së pari duhet të promovojnë kuptimin e gjerë muzikor. Inkurajimi dhe pasioni për artin e të kënduarit është shansi që i duhet dhënë çdo fëmijë për të përjetuar në këtë fazë të jetës momente të bukura së bashku! Zëri këngëtar i fëmijës nga mosha pesë deri dymbëdhjetë vjeç zotëron një timbrikë të natyrshe në formacionin e një kori. Ky



EDUKIMI PËRMES ÇEDUKIMIT

tingull kolektiv prej të miturish, i ashtuquajtur “kor i engjëjve”, krijon një ngjyrë vokale të papërsëritshme, që humbet pastaj me moshën. Të kënduarit në grup, në ansambël, apo kor është mediumi ideal për fëmijët për të komunikuar, për të shprehur ndjenjat dhe mendimet, por edhe për të çliaruar stresin emocional. Mbi të gjitha, të kënduarit unifikon dhe forcon vetësigurinë sociale. “Të kënduarit është gjuha e vërtetë e mëmës për njerëzimin”, thotë Yehudi Menuhin, (përtej asaj për të cilën ai njihet) mentor dhe mbrojtës i iniciativës “Kënga e Botës”. Konkursat në këtë rast nuk janë një punë e mirë lobimi për vlerat që ato premtojnë të mbartin si iniciativa edukuese! Edukimi përmes muzikës në bashkësi nuk ka të bëjë me diferencimin, selektimin a kufizimin e fëmijëve përmes konkurseve, as përparësinë që mund t’u jepet paraqitjes së fëmijëve me aftësi të përsosura vokale. Në përvojat e mia si “Vocal coach” (trajnuese vokali) qoftë me banda e këngëtarë profesionistë, por dhe me projekte të natyrshe edukative për zhvillimin muzikal

parashkollor siç ka qenë projekti: “Wir singen” (“Ne këndojmë”), realizuar në landin e NRW-së në Gjermani, kam shquar deficite dhe problematika të cilat zanafillën e kishin te pengimi i të kënduarit në vogëli. Kush kërkon të frenojë dëshirën e fëmijës për të kënduar, për shkak se prindit, edukatorit, mësuesit, gjtonit i duket ulërimë dhe jo të kënduar i mirëfilltë, së pari duhet të mos e shohë këtë si të metë, por si dëshirë të fëmijës për t’u artikulluar ndryshe. Në këtë rast vlen thënia: “Jepi shans ulërimës së fëmijës të bëhet zë, për ta gdhundur më tej drejt këngës. “Heqja dorë nga të kënduarit në fëmijëri, ka implikime të mëdha në zhvillimin e personalitetit dhe formimin emocional të fëmijës. Shumë njerëz të kënduarit e lidhin me përvojat e tyre negative, kur janë ndier me turp në fëmijëri, ose kur janë bindur se nuk mund të këndojnë, sepse janë ndier inferiorë për shkak të rrethanave sociale, racore ose metodave të gabuara edukuese, ose sistemit jokorrekt politiko-arsimor. Parë psikologjikisht dhe muzikalisht, kjo më nxit të prek një paradoks

në Shqipëri: Pse adoleshentët konsumojnë muzikë katër deri pesë orë në ditë, dhe kjo ndodh në mënyrë pasive duke dëgjuar me kufje iPods, Smartphone etj, në vend që të mësojnë një instrument dhe të bëjnë vetë muzikë? Priremta shpjegoj këtë me shpërndarjen e pabarabartë të mundësive, rrethanave dhe niveleve sociale dhe mosmotivimin që ata kanë ndier qysh në vogëli. Shumë nga të rriturit e sotëm nuk kanë guxim t’u këndojnë fëmijëve të tyre qoftë edhe një “Patat dhe rosat lahen në liqen!” “Kush mund të flasë, gjithashtu mund të këndojë”. Ndaj nuk e shoh me vlerë termin “elitar”, as konkursat, koncertet a la “Gala”, apo proçkat televizive “Ti vlen” etj. Gjithashtu, “Miti i talentit” mund të gjejë fushë veprimi ndryshe. Jo në konkurse të formatit komercial, as në spektakle televizive, ku shpesh fëmijët dhe adoleshentët traumatizohen dhe demoralizohen deri në humbje të vetëbesimit!

Të kënduarit në mënyrë të vazhdueshme dhe të pandërprerë, ndihmon që sinapset në tru të rikombinohen – duke e bërë fëmijën edhe më të zgjuar, më të mprehtë.

mijën edhe më të zgjuar, më të mprehtë.

“Eja këndo...”, apo çfarëdo iniciative tjetër edukative përmes muzikës-artit, duhet t’u ofrojë fëmijëve terren për të vetëzbuluar pa drojë zërin e tyre, duke u rritur me njëri-tjetrin përgjatë këtij procesi. Pasioni është ngjitës, ndaj zotërimi i funksioneve vokale dhe përdorimi i shëndoshë i zërit në të folur dhe të kënduar është një proces zhvillimi shumë delikat, që duhet të nisë në vitet e para të jetës brenda familjes, në kopsht e më pas në programet shkollore.

Të kënduarit çliron dhe shëron të madh e të vogël.

Le të sjell shembullin nga Dhjata e Vjetër, ku thuhet se: “Muzika dhe kënga kuron mendjen dhe shpirtin e sëmurë”. Davidi, djali i bariut, mbreti i ardhshëm i Izraelit, e kuron mbretin Saul me këngën dhe harpën e tij. Pas këtij efekti terapeutik, Sauli e kuptoi dhe tha: “Unë mund të jem një mbret i mirë për popullin tim, nëse nuk e harroj bariun e mirë, i cili më jep atë që kam nevojë për të jetuar. Kënga e tij më shpëtoi nga fatkeqësia dhe rreziku”.

“E VËRTETA PËR NOLIN” NGA ENTELA KOMNINO VJEN NË PRISHTINË

Entela Komnino, e njohur si gazetare në televizionin publik shqiptar, doktore në Letërsi, është autorja e librit më të fundit për Fan Nolin me titullin “E vërteta për Nolin”.


Libri i promovuar së pari në Ministrinë për Evropën dhe punët e jashtme të Shqipërisë, e më pas edhe në Universitetin e Tetovës, do të jetë në duart e lexuesve të Kosovës që nga dita e premtë kur në Prishtinë do të bëhet paraqitja

e tij. Promovimi i “E vërteta për Nolin” në Kosovë bëhet nga Instituti i Historisë “Ali Hadri” në Bibliotekën Kombëtare të Kosovës më 16 shkurt.

Entela Komnino jeton dhe vepron në Tiranë. Ka kryer studimet në piano dhe histori arti në Liceun Artistik Tiranë dhe më pas Gjuhë dhe Letërsi në Fakultetin Histori-Filologji të Universitetit të Tiranës. Në vitin 1994-1995 ka kryer studimet pasuniversitare, retorikë

e gazetari televizive në universitetin e Tuebingenit në Gjermani. Ka përvojë edhe si gazetare në mediet e Shqipërisë dhe të Kosovës, por gjatë është marrë edhe me studime të ndryshme.

Në vitin 1997 ka botuar librin 30 minutat e darkës ‘20 që ka të bëjë me historikun e lajmit televiziv në Shqipëri që nga fillimet e tij. Është doktore shkencash në letërsi me disertacionin Kodi retorik në publicistikën e Fan Nolit.




JA ÇFARË NA MËSON TOLSTOI ME "ANA KARENINËN"

"Ana Karenina" është një roman romantik tipik i letërsisë ruse, i shkruar plot me detaje që të mbeten në mendje, por që transmeton edhe një ngarkesë të fuqishme emocionale. Ana, personazhi kryesor i veprës, nuk e gjen veten gjëkund në martesën e saj dhe, pasi një aventurë jashtëmartesore, e gjen veten në shinat e trenit, e gatshme për t'u vetëvuar për mëkatën që ka bërë. Nëse gjatë gjithë veprës personazhi i saj transmetonte neveri për atë që i bënte bashkëshortit, në fund gjithsecili nga ne ndjeu dhimbje për vdekjen e saj. Këtë fuqi për të t'i ndryshuar komplet emocionet e kanë shumë pak autorë. Kujtojmë këtu se të njëjtin efekt na ofron edhe Flaubert me "Zonja Bovari".

Tolstoi duket sikur e ka tejkaluar veten me romanin "Ana Karenina", pasi i ka falur botës një kryevepër që ka kryesuar kushedi se e sa klasifikimeve për librat më të mirë. I nisur me fjalinë "Të gjitha familjet e lumtura janë njësoj, ndërsa familjet jo të lumtura janë të gjitha jo të lumtura në mënyra të ndryshme", Leo Tolstoi na jep këto mësimet përmes kryeveprës së tij:

1. Jo çdo gjë që shkëlqen, është prej ari.

Kur 18 vjeçarja Kiti u përball me dy djem që e pëlqenin, ajo zgjodhi Vronskin, në vend të Levinit. Ajo mendonte se Vronski ishte më i paraqitshëm dhe më sharmant, por



pavarësisht se ai flirtoi më Kitin, më pas zgjodhi Anën dhe në fund i la të dyja me zemrën të thyer. Ndërkohë Levini, vërtet duket në fillim personazh antipatik për lexuesin, por në fund rezultoi një partner shumë besnik.

2. Divorci duhet të jetë një zgjedhje e pranuar nga shoqëria.

Romani është shkruar në një periudhë, kur divorci konsiderohej një tabu. Divorci ishte e kundërta e lum-

turisë, prandaj dhe përballë një fakti të tillë, Ana nuk divorcohej dot nga bashkëshorti i saj që nuk e bënte të lumtur. Por nëse e mendojmë mirë, një paragjykim i tillë për divorcin nga shoqëria e asaj kohe, na bën të mbajmë në duart tona një kryevepër të letërsisë botërore. Imagjinoni pak nëse Ana do të ishte ndarë prej bashkëshortit të saj. Sot nuk do të kishim një vepër të kësaj natyre.

3. Të martohesh në moshë të re, është një zgjedhje jo tepër e zgjuar.

Vitet e fundit është vënë re një rritje e moshës mesatare të martesës. Moshë mesatare e martesës për femrat është 27, kurse për meshkujt 29 (në ndryshim nga 23 për femrat dhe 26 për meshkujt në vitet '90). Ky është një ndryshim shumë i mirë, pasi të dy partnerët janë më të përgatitur për jetën në çift. Tolstoi ndoshta nuk e parashikoi këtë tendencë të shoqërisë moderne, por ai ka shkruar në vepër për vështirësitë e martesës në moshë të re. Për të nxjerrë në pah pikëpamjet e tij, autori e vendos martesën e Levinit në moshën 32 vjeçare dhe që në fund të romanit, ai rezultoi të jetojë më i lumtur se personazhet e tjerë që martohen më të rinj.

4. Ne nuk e kemi fuqinë të ndryshojmë "ligjet" e shoqërisë ku jetojmë.

Ajo që është pjesë e shoqërisë sonë, kërkon kohë të ndryshojë. Normalisht, "ligjet" arbitrare të shoqërisë ishin të padrejta për Ana Kareninën. Të shqetësohesh për të dalluar "të drejtën" nga "e padrejta" është tunduese dhe mund të jetë më pak produktive, se sa të mendosh për një mënyrë pozitive për të bashëpunuar me situatat e padrejta ekzistuese.

5. Romanca dhe dashuria e vërtetë ekzistojnë.

"Ana Karenina" është natyrisht një tragjedi. Një femër rrezikon gjithçka që ka në emër të dashuri-

së së vërtetë, dhe arritja e një dashurie të tillë është fatale për të. Pavarësisht fundit tragjik, përgjatë gjithë veprës jepen mesazhe të shumta për dashurinë dhe lumturinë.

Levini dashurohet me Kitin që në momentin e parë që e sheh dhe nuk i ndalon përpjekjet e tij për ta bërë për vete, edhe pse ajo e refuzon. Çifti has vështirësi në momentet e para pas martesës, por në fund, krijon një jetë të lumtur bashkë.

6. Rutina nuk është e mërzi-shme.

Levini, që është personazhi më pozitiv në vepër, ndiqte një rutinë të njëjtë dhe ishte i lumtur me këtë pjesë, deri në momentin që miqtë e tij borgjezë e nxinin të ndryshonte stilin e tij të jetesës. Nëse më parë ai zgjohej shpejt dhe bënte punë fizike, ata e shtynin të shkonte në opera, apo të merrte pjesë në gossip. Këto aktivitete ai nuk i pëlqente aspak, pasi ndihej më mirë me rutinën e zakonshme që ndiqte më parë.

7. Askush nuk jeton një jetë të lehtë.

Levini punonte me fshatarët që kishte punësuar dhe thuhet se Tolstoi ka bërë të njëjtën gjë në kohën e tij. Autori hapi shkollë për fëmijët e bujkrobërve të tij dhe i thurte punëtorëve lavde për meritat e tyre.

BOTA E LIBRIT

"Elefanti zhduket", Haruki Murakami

"Elefanti zhduket" është një tufë rrëfenjash fine, në stilin e njohur postmodern të Haruki Murakamit, ku shfaqen të gjitha nuanca kulturore japoneze që e dominojnë



prozën e këtij autori, por edhe shenjat universale të kohës sonë të endura nëpër gjeografinë e gjerë të fantazisë së tij.

Si një mjeshtër i adhuruar për ndërtimin e personazheve aq të besueshëm, ai na dizajnon profile të çuditshëm dhe mahnitës karakteresh, të cilët, përmes grimcave të jetës së tyre të përditshme, duken sa të ngjashëm mes vedi, aq edhe bartës të unit të tyre dallues. Fuqia e tij narrative, u jep mundësinë këtyre personazheve të vetërrëfihen për familjen, karrierën, dashurinë, vdekjen, miqësitë, të njohurit e të huajt që janë pjesë e jetës së tyre, duke bartur në rrëfime dhe filozofinë e tyre personale, e që ashtu bashkë, i japin lexuesit një ngrehinë mahnitë-

se të populluar nga qenie reale dhe surreale, siç vetëm Murakami di të na i dhurojë. Pas suksesit në shqip të një sërë romanesh, ky vëllim me proza të shkurtëra, i paraqet lexuesit shqiptar një dimension tjetër mjeshtëror të këtij autori të adhuruar nga miliona lexues në botë. Shqipëroi: Ivana Derishi

Shtëpia botuese: Skanderbeg Books

Vajza daneze, David Ebershoff

I vendosur në shkëlqimin e Kopenhagës, Parisit dhe Dresdenit të viteve 1920, romani zbulon kufijtë e seksit dhe gjinisë, martesës e dashurisë si dhe rrugën drejt gjetjes së vetvetes.



Frymëzuar nga një histori e vërtetë, ky portret delikat ngre pyetjen: ç'duhet të bësh kur njeriu që do papritmas ndryshon? Gjithçka nis me një pyetje, me

një kërkesë të thjeshtë për ndihmë që ajo i bën bashkëshortit, teksa pikturojnë në studion e përbashkët, duke i hapur udhë shndërrimit që nuk i shkonte në mend askujt.

Si bashkim i së vërtetës me trillin, për të krijuar një vepër të veçantë me tis romantik, "Vajza daneze" portretizon me rrjedhshmëri intimitetin e veçantë që karakterizon çdo martesë, historinë mbresëlënëse të Lili Elbës, nismëtares së ndryshimeve transjinore, si dhe gruan e dyzuar mes besnikërisë ndaj martesës dhe dëshirave e ambicies vetjake.

Proza e shkëlqyer dhe zhbirimi emocional e bëjnë "Vajzën daneze", deri në faqen e fundit, një roman shumë prekës dhe një nga historitë më të zjarrta e të pazakonta të dashurisë në shekullin e njëzetë.

Shqipëroi: Jorgji Qirjako
Shtëpia botuese: Dituria

"Me arvanitët udhëve të Greqisë", Luan Rama

Libri "Me arvanitët udhëve të Greqisë" i Luan Ramës vjen si një gërshetim i publicistikës dhe historisë, ndërsa shkrimtari rreket të sjellë dëshmi të rëndësishme mbi arvanitët në Greqi. Autori ka nënvizuar se "Në librin tim "Me arvanitët udhëve të Greqisë" i refe-

rohem jo burimeve shqiptare, por atyre greke dhe europiane që nga shekulli XVII (historianë, gjeografë, konsuj, arkeologë, publicistë, etj): së pari, librit me kujtime të Konstantin Metaxa si dhe kujtimeve të konsullit francez Eugène Pujade kur kolonel Zorba e shoqëroi në fshatrat e Sulit ku flitej shqip dhe ku dhe ai thotë se ishte shqiptar". Nisur nga udhëtimet e shpeshta të autorit në Greqi dhe takimeve me arvanitas në zona të ndryshme si në Peloponez, në Thiva, Evia, në Athinë apo Mandra, Korint, Vilia, etj, hidhet dritë mbi emigracionin shqiptar në jugun e Greqisë që në kohën bizantine. Ajo që është më interesante janë referimet ndaj librave të shumtë të udhëtarëve të huaj në Greqi, francezë, anglezë, gjermanë, etj., dhe pikëtakimeve të tyre me shqiptarët, veçanërisht në shekujt XVII, XVIII dhe XIX.

Theksi i autorit është që kjo lidhje e vjetër midis shqiptarëve dhe grekëve në histori duhet t'i shërbejë ardhmërisë së dy popujve fqinj.



I ndarë në katër pjesë, ose në katër nivele që krijojnë strategjinë narrative të romanit, sikundër janë: Thesari për luftën, La Ceinture de Chastete (La sentyer de shastete), (Brezi i virgjërisë), Kalëruesi i humbur, Continuum, romani 'Autoportet me teleskop' i shkrimtarit Besnik Mustafaj imponon para lexuesit sfidën për t'u ballafaquar me një lëndë komplekse, sa heterogjene si teknikë dhe metodë krijuese, po aq edhe voluminoze si informacion estetike e letrar për një tipologji të gjërë ngjarjesh, karakteresh e shtrirjesh kohore dhe hapësinore

FILOZOFIA POETIKE NË PROZËN E BESNIK MUSTAJ



Koha

Emin AZEMI

Romani 'Autoportet me teleskop' i shkrimtarit Besnik Mustafaj është një produkt i pastër letrar, që vjen pas një heshtje të gjatë krijuese, por që gjithë këtë heshtje ai sikur e justifikon me veprën e fundit, e cila për shumëçka është unike në mbarë letërsinë moderne shqipe. Në radhë të parë, ajo është një manifest estetike i shkruar në vazhdimësi, madje edhe para se autori të vendoste të shkëputej nga politika, sepse procesi i krijimit nuk ndodhë vetëm gjatë aktit fizik të shkruarit, por edhe përtej kësaj. Nëse një njeri që e lë këtë botë dhe pas tij mbetet një testament për trashëgimtarët e tij, për shkrimtarin kjo do të mund të transformohej në një përvojë pak a shumë tjetër, ku fikcionaliteti e bënë atë të jetojë me bashkëkohanikët edhe pasi ta ketë përfunduar veprën për të vërejtur nga afër reagimet dhe efektet e atij fikcioni. Dhe kësaj, Besnik Mustafaj ia ka arritur.

LEXUESI—NJË BASHKËUDHËTARI PADUKSHËM

Politika, si profesion që i ndihmoi narratorit të krijojë një personazh (homonim) letrar, autorit i ka shërbyer vetëm si katalizator për të përshpejtuar procesin e njohjes me një jetë dinamike, e cila jashtë politikës nuk do ta kishte dramën që e ka romani. Ndonëse edhe vetë Mustafaj e thotë me një rast, se ky roman në palcën e tij është politik, prejardhja e këtij konstatimi që nuk është ekstra zhanror, megjithatë nuk na pengon ta shikojmë atë pak më thellë, duke depërtuar në zona që vetëm një shkrimtar i talentuar di të ecë, duke qenë i sigurt se rrugët nga po ecte, për herë të parë po i shkelte dhe në gjithë atë rrugëtim kompleks, sikur lë vend edhe për një bashkëudhëtar të padukshëm, për të bërë një transfer semantik të kodeve nga shkrimtari tek lexuesi, sepse vetëm duke qenë interaktiv në aktivitetin narrativ, shkrimtari dhe lexuesi krijojnë plotninë e perceptimit të veprës.

E ndarë në katër pjesë, ose në katër nivele që krijojnë strategjinë narrative të romanit, sikundër janë: Thesari për luftën, La Ceinture de Chastete (La sentyer de shastete), (Brezi i virgjërisë), Kalëruesi i humbur, Continuum, kjo vepër imponon para lexuesit

sfidën për t'u ballafaquar me një lëndë komplekse, sa heterogjene si teknikë dhe metodë krijuese, po aq edhe voluminoze si informacion estetike e letrar për një tipologji të gjërë ngjarjesh, karakteresh e shtrirjesh kohore dhe hapësinore. Prandaj edhe nuk do të bënim ndonjë gabim metodologjik, sikur këtë vepër ta copëzonim në fragmente, për ta kapur më afër natyrën e procedeut, mirëpo kjo do të na shkaktonte telashe jo të vogla për ta perceptuar plotninë, e cila, megjithatë ka një rrjedhë dhe një dinamikë të brendshme narrative dhe si e tillë do të duhej një receptim integral i njësive të veçanta tekstore brenda gramatikës së plotë rrefimore.

Kjo dinamikë fillon në momentin kur narratori që identifikohet me heroin letrar Besnik Mustafajn, ndodhet në detyrën e ministrit të Jashtëm tek merr pjesë në një konferencë ndërkombëtare në Monaco, me përfytyrimin se në një kohë të keqe dhe në një vend të keq do të përfshihej në një telash të madh.

Një pe i hollë dhe gati i padukshëm që lidhë amplitudat e zhvillimit të fabulës është ecja e narratorit nëpër fushën imagjinative të jetës së përjetuar dhe transformimit e saj në një realitet të ri estetike, sepse shkrimtari ka rrugën e tij, që është vetëm e tij, për të mbërritur tek të fshehtat e njeriut, atje ku edhe e ardhmja është abstrakte dhe mjaftonte për të ngjallur frikë.

Kjo ecje bëhet duke bartur me vete edhe dromca të patretura nga e kaluara, pa të cilat narratori nuk do të mundte të projektonte disa nga pikat referenciale të retrospektivës dhe perspektivës kohore që lehtë mund të shëmbëllojnë në figurën komplekse të Selami Beshirit, të cilin narratori e risjell në vëmendje për ta rishikuar edhe një herë në një mbrëmje të vonë në Bruksel.

Jo vetëm pse Selami Beshiri kishte një ëndërr të parealizuara qysh nga fëmijëria e hershme: të shuante nepsin për sallame e salciqe, por edhe pse ai, si karakter do ta nxisë narratorin të bëjë hulumtime shtruesore për të ndjekur diagramin e formimit dhe transformimit të personalitetit në dy kohë dhe hapësira krejt të ndryshme. Ky portretizim aspak stereotip dhe krejt original, e nxjer në sipërfaqe prijet e autorit për të ndërtuar albinë e krijimit të situatave groteske,

sikur në rastin e Selami Beshirit, të cilin, siç thotë autori, sistemi kompleks dhe i kudogjendshëm e kurdoherëshëm i propagandës dhe edukimit të regjimit revolucionar nuk kishte arritur t'ia rrënjoste një ëndërr që t'i mbijetonte kohës, gjë që e kishte arritur një spot publicitar për sallamërat belge.

'Autoportet me teleskop', si një sporovë e guximshme letrare, e vendos ngadonjëherë autorin në pozitë të pabarabartë me kureshtjet e panumërta të publikut, i cili me maninë e sipërfaqësive dhe përtacisë për t'u thelluar më tepër në leximin e veprës, kërkon të nxjerr jashtë kontekstit letrar personazhe e situata të caktuara. I ardhur në letrat shqipe si një individualitet, që kishte lënë gjurmë të pakontestueshme të formimit estetike në veprat pararendëse siç ishin romanet: 'Vera pa kthim', 'Një sagë e vogël', 'Boshi' dhe një opus i pasur poetik, autori i romanit që tani lexuesi ka në duar, është treguar mjaft bujar me ofertën e tij për një dialogim me lexuesin, duke kërkuar nga ai pjesëmarrje aktive receptive në periudhën postkrijuese të këtij romani. Mbase është për t'u admiruar kjo praktikë e autorit, sepse vetëm në këtë mënyrë arrihet emancipimi estetike e recipientit, pa të cilën edhe nuk mund të zhvillohet shprehja e komunikimit me veprën letrare.

CILAT METODA KA PËRDORUR AUTORI?

Nëse mund ta quajmë sprovë të guximshme, sfidën për të reduktuar maskimalisht distancën në mes të autorit dhe narratorit, gjithashtu do ta konsideronim si paradigme socio-kulturore edhe metodën krijuese të shkrimtarit Besnik Mustafaj, e cila në aspektin teorik e estetike do të mund të formësohej si një manual udhëzues për lexim kreativ.

Çka mund të mësojmë nga ky manual, me kusht që ai të kundrohët brenda planimetrisë narrative që autori i skicon si metoda pune?

a) Në fillim çdo kapitull, në retrospektivë përsëritet dhe spjegohet më detajisht rrefimi paraprak. Ose sekuenca narrative – njësia përbërëse e të rrefyerit, e cila edhe vetë është e aftë të funksionojë si rrefim. Në romanin 'Autoportet me teleskop', këto sekuenca narrative paraqiten edhe si seri situatash e ngjarjesh, nga të cilat e fundit në

radhë paraqitet si përsëritje e pjesshme, apo transformim i së parës.

b) Alternacioni si gjetje origjinale e autorit, ku kombinimi i niveleve narrative bëhet në atë mënyrë që njësitet e njërit nivel alternohen në njësitet e nivelit tjetër.

c) Rrefimi metadijegetik brenda një kornize, ose rrefimi i cili funksionon si kornizë e rrefimit tjetër, duke i siguruar atij ambient funksional dhe kontekstualizim të semantikës së objekteve dhe ngjarjeve.

ç) Vëzhgimi depërtues dhe kohezioni në mes të personazheve.

d) Struktura epike e narracionit në roman funksionon në trekëndëshin: personazhet – hapësira – veprimi.

Gjuha si kod semantik shenjash e mesazhesh, në romanin e Mustafaj paraqitet në dimensionin e dyfishtë: në aktin e të rrefyerit dhe aktin e përvetësimit. Çdo histori që rrefehet këtu, që nga misteri reth thesarit të luftës, pastaj aventurat e përcjella me groteskun urban të tipave, si Selami Beshiri, Bilal Barzezi, dialogu me Ana B., episodit paradoksal e tragjikomik me gruan angleze në aeroportin e Athinës, telasht me gruan që shite qumshtin e gjirit në një metropol europian dhe rënia pre e naivitetit të një emigranti shqiptar në këtë histori, skenat gati filmike të një jete të braktisur rurale, janë disa nga bërthamat semio-tematike që aktin e të rrefyerit e përplotësojnë me dimensionin e përvetësimit.

IMPLIKIMET PSIKOLOGJIKE E FILOZOFIKE

Shtresa e objekteve të romanit përbën inventarizimin alegorik të gjërave që në fakt është bota, të cilën në mënyrën e tij shkrimtari e bartë në veprën letrare, e që duket të jetë reale. Por në fakt ekziston vetëm si realitet estetike (gjuhësor), me të cilën sugjeron situata jetësore, sepse siç e thotë edhe vetë autori në një intervistë teleskop, sa ç'është konkret, aq edhe jepte dorë për një metaforë me kuptime të shumëfishta.

Një prej atyre objekteve është edhe teleskopi, një lajtmotiv ky që i ka shërbyer autorit për ta ndërtuar intrigën fabulative të njeriut, që kishte nevojë të zhdukte distancat gjeografike dhe ideali për të braktisur ndjenjën që të krijon izolimi, të sygjeron të mendosh për objekte që i rela-

tivizonte kufijtë dhe distancat, siç mund të konisderohej edhe teleskopi si një objekt që i reduktonte këto parametra hapësinore, sepse, siç e thotë edhe vetë autori teleskopi, sa ç'është konkret, aq edhe jepte dorë për një metaforë me kuptime të shumëfishta.

Në roman, shtresa lëndore e objekteve është ngusht e lidhur me shtresën e aspekteve tematizuese, kurse aktivizimi i kësaj shtrese vë gjatë leximit, kur edhe bëhet kombinimi i objekteve me personazhet dhe marrëdhëniet në mes vete.

Por e veçanta e këtij romani qëndron në resurset gjuhësore e stilistike për të sugjeruar vetëm ato mesazhe që burojnë nga vetë vepra, duke e ndihmuar lexuesin të mos jetë kaotik në perceptimin e sistemit figurativ të ngjarjeve e personazheve. Autori me këtë vetëm se vërteton teorinë e Ingardenit mbi funksionin e lexuesit në 'rikrijimin e veprës'.

Në lidhshmërinë sintetike të fakteve letrare, autori nuk ndjek ndonjë shkollë të caktuar historiografike, por bën zhvillimin e atyre përvojave me të cilat lexuesi i qaset veprës letrare.

Ajo që në roman karakterizohet si dramë e individit dhe fati i kolektivitetit, nuk do të mund të arrihej pa implikimet psikologjike e filozofike, të cilat autori i përdorë me mjeshtri, dhe kjo mund të vërehet sidomos në rastet kur personazhi paraqitet si inkarnim i tëhuajimit dhe epshit, ose si peng i frikës për të panjohurën, por edhe për të papriturat e lirisë. Përjetimi i brendshëm i individit bartet në realitetin kompleks që e rrethon, kurse vetmia e njeriut, i rrethuar me frikën, paragjykimin, inkorporohet në toposin malor, që drejtpërdrejtë ndikon edhe në formimin e karakterit të mikrokosmosit. Letrarizimi i botës së individit dhe konflikti i kësaj bote me rrethin...

Çdo personazh i këtij romani është episod nga seria e gjatë e quajtur jetë. Autori i afrohet me këtë konceptit letrar që kishte Tolstoi mbi jetën: mikrokosmosi derdhet, ose shkrihet në makrokosmos dhe përpjekja titanike për t'u dukur i veçantë nga kjo turmë socio-antropologjike, në momente e rrethana të caktuar kishite edhe kosto të lartë për vetë lirinë dhe jetën e njeriut.


Tragjika dhe grotesku i qenësimit njerëzor, e përkohshme dhe e përherëshme, fantasshkenca, ëndërra, erosi përbëjnë linjat karakterizuese identitare të kësaj vepre, ndërkohë që ndërtimi i arkitekturës së romanit ecë bashkë me zhvillimin dhe formimin e personazheve, nga një kohë, në një kohë tjetër, nga një hapësirë në një hapësirë tjetër. Selami Beshiri, Bilal Barzezi, Muzafer Zhivini paraqesin tipologjinë komplekse të portretizimit psikologjik të njeriut, që kishte lëvizur nga një kohë e brishtë rimore në një pjekuri burrërore, nga një vetmi rurale në një kaos metropolitan. Origjina sociale e shpirtërore e personazheve, bashkë me follenë e kujtimeve, krijojnë shtratin mjaft dinamik të rrefimit, ku derdhja e lëndës narrative nuk bëhet në një kallëp të ngurtë e të mbyllur hermetikisht. Mjeshtria e autorit qëndron pikërisht në krijimin e një kallëpi mjaft elastike brenda të cilin lëviz lënda narrative.

TEKI DËRVISHI:

BEQIR MUSLIU, I PARI POET POSTMODERN SHQIPTAR

Poeti, romansieri, dramaturgu, eseisti dhe publicisti Beqir Musliu është përfaqësuesi i parë i postmodernitetit në letrat shqipe. Lirika e tij sublime që u paraqit në vitet e gjashtëdhjeta në letërsinë shqiptare shquhet me veçorinë e saj, me origjinalitetin. Bashkë me Jusuf Gërvallën, Beqir Musliu është poeti më lirik në letërsinë shqipe jo vetëm të kohës së tij krijuese, por edhe më larg. I takon grupit të vogël të atyre krijuesve shqiptarë që asnjëherë nuk lejuan të instrumentalizoheshin politikisht, duke i ndejtur besnik vokacionit krijues të artistit. Kështu arti i Beqir Musliut mbeti një opus kombëtar si një vijë në lidhjen e kontinuitetit të rilindasve shqiptarë. Është i pari ose më i miri nga mjeshtrit e fjalës artistike që e ngjalli metaforën e harruar të artit gojor shqiptar, duke i ritrajtuar poetikisht epet dhe legjendat shqiptare. Këtë metaforë ai e ngjalli me rafinmenin e gjuhës së artit dhe e nxori nga përdorimi arkaik që zvarritej në poezinë soc-realiste. I çliruar nga ngarkesat ideologjike, ai pati një ideal krijues: ta bëjë të flasë kumbueshëm shpirti i gjuhës shqipe. Fati i krijuesve të mëdhenj, siç thoshte Kishi, është i ngjashëm, madje identik. Edhe jeta krijuese e Beqir Musliut është një metaforë e fatit që i përcjell krijuesit e mëdhenj dhe opuset e tyre që bëjnë thesarin e kulturës së një kombi. Si e tillë, si vepër madhështore, arti i Beqir Musliut letërsisë shqipe i dëshmoi dy dhunti që janë më karakteristike: ai ishte mësues i brezave të rinj krijues, poeti që pati më së shumti ndikim në brezat dhe gjeneratat e reja dhe dy, vepra e tij dëshmon se në artin shqiptar megjithatë ka pasur si ai dhe të tjerë – krijues që nuk u janë nënshtuar diktateve dhe hartimeve ideologjike për t'i shitur si art, krijues të formatit të madh si Beqir Musliu, i cili ia fali tërë qenien e vet krijuese artit dhe që u pajtua të jetë skllav i artit të vet, të vetmes gjini të bukur të jetës së tij.

Beqir Musliu ishte krijuesi më i madh i kohës së tij dhe si i tillë do të mbetet bashkë me më të mëdhenjtë që ka letërsia shqiptare.



Beqir Musliu



SKËNDERBEU

(poemë - magjistrali)

Gjuha e shkri në diell si fjala 'pëshertima
E gurit të fortë në dashni emën i kish dhënë
Rrugës së shtruar me trëndafila e shkrepitima
Cjakun për ta ruajtë bashkë me shqipen Nanë
Kalanë mbi andërr e çelën vetëm andrrat e veta
At'botë kur shqiponjat sollën gëzim dhe dritë
Së bashku me malësorët e kunorëzuen
ndër shkrepja
Të madhnuem me kohën e Arbërit mbetën
historitë
Rrugës së lavdisë kush i doli mbanë aq krenar
I madh në dashni dhe i patundun në shpresë
O vetëm shqipja që fërfëlloi flatrat në zjarr
Tash me të urtin Prometeu u zgjua në histori
I bani të lirë e të oastër të lidhun në besë
Tanë Ballkanin e madhnoi me Bijtë e tu Arbën

EPILOG

NË TROLLIN e lashtë e të madhnuem të Arbërisë
Askush nuk pati aq fuqi sa me shkimë zjarrin -
Por, ajo në verën e vet e çeli lulen e barin
Me përjetue aq të pastër Parajsën e Bukurisë.
Por ... - deri te Troja e re, e quajtn: Iliri
Edhe shpata e vuejti ndhimbje historinë e vet
Para dashnisë secili u kthy' n'gërmadhë, mbet -
Legjendë mbi fatosat që u flijuen për Liri!
Kumbonat e trandën bjeshkën në ankth
e kumbim,
Deri në gjelbrimin e pranverës së zeze n'ar -
Kangëtarët e rinj i nxorrën lahutat për këndim.
Me na shpie në një kohë që na duhet me e dashtë -
Për të cilin lulja n'ballsamim u zgjue me na varë
Aty, ku shqipja e pavdekëson Skënderbeun e lashtë !

(POSTSCRIPTUM)

DIKUR edhe djajtë shitoreshin n'zili me hovin tand
- Edhe tokës me të grishë n'emën i vinte randë.
Fusha shkretnohej, e lumi rridhte në atë pik'llim
Nuk lindte kanga, as lahuta s'binte n'tërbim -
Kur vorrimi yt i shejtë u ba mbi këtë Dhe
N'gojë u ngrinë klithmat për ty, o Skënderbe
Dhe të uruen si shejtnitë - Prometheu me qenë
Me ujitë me gjakuntand djersën e me vesë lulen
Me mbjellë synin tand si ma t'mirën dritë n'male
Aty, ku trimninë dhe krenarinë bjeshkëve ua fale!
Tash po jeton edhe aty ku s'kanë dijtë me të dashtë
Mbi shkrepja je ngritë si petrit me shpatën e lashtë -
Aty, ku dikur ashti yt shëronte o çdo plagë e varrë
Që mbajte tanë Ballkanin për emnin tand, o varë ...
Tash - të grish me zbritë edhe shqipja në kreshtë
Katundari në mal, e blerimi me të pasë edhe n'vjeshtë.
Bjeshkët me ty me u krenue në pikëllime e n'hare -
Kur ti ende jeton madhështor mbi ne, o Skënderbe !
Lulet tue u rritë edhe nëpër çdo saksi e n'dritare -
Dielli tue të ngrohë në Krujë, Lezhë, në tokën kosovare !
Gjithkund kanë klithë e kanë brohoritë: "O, Skënderbe -
Ti që na shpëtove, ti që na ktheve votër e A t d h e !"
Kalatë u ngritën për hir tandanin deri n'qiell e n'naltësi -
Me mbrojtë qetësinë tande me shqipen të lirë n'malësi
Tash je shtri dhe po rrin mu aty ku s'të harruem
- Në tokën që për ty, përherë ka klithë dhe pa le
Aty, ku edhe gurët kanë hapë gjuhët, o Skënderbe -
Aty, ku si perëndi, e shenjt t'Madh t'dashnuem !
Aty, ku lulet thaheshin n'brymë me vesën si ar -
Të mban të gjallë ndër kohë e mote çdo shqiptar !
Po të shohim t'gjallë pranë luleve në një, o, Kumbonë
Flakën në hinin e gjallë tue ndezë përsëri me flakë -
Tue lindë prapë vigab si lulja e re mbi saksi e gjak -
Tash me emnin tand po e shërojmë edhe sëmundjen tonë !

(GJILAN - PRISHTINË, 1963 - 1968)

15 GJËRA QË NUK DUHET TË BËNI PARA MBRETËRESHËS ELIZABETH!



Takimi me Madhërinë e Saj mund të jetë një rast i papërsëritshëm, por nëse nuk dëshiron të përballosh rrezikun e gabimeve ose, më keq, mosrespektimin e sovranes, duhet të ndiqni këto rregulla. Duke filluar që nga shprehja "pardon" dhe deri duke u ulur para saj...

TË ULESH. Siç shpjegohet në faqen e internetit të CheatSheet, gjëja e parë që nuk duhet të bëni kurrë para Mbretëreshës së Anglisë është që të qëndroni ulur: mos të ngrihesh kur mbretëresha hyn në dhomë, tregon mungesë respekti ndaj saj.

TA QUANI MBRETËRESHJA ELIZABETA. Edhe pse është emri i saj dhe titulli zyrtar, ta thirrni Mbretëresha Elizabeta është një hap tjetër i gabuar: kur në të vërtetë ju takoni sovranen për herë të parë, gjithmonë duhet t'i referoheni asaj me titullin "Madhëria e saj".

TË VAZHDONI BISEDËN. Kur flasim me Mbretëreshën (ose ndonjë anëtar tjetër të familjes mbretërore), duhet të flasim vetëm kur dikush na e kërkon dhe në asnjë mënyrë nuk duhet ta vazhdojmë bisedën, sepse "plumbi" i fjalës duhet të jetë gjithmonë në duart e vërteta.

T'I KTHENI SHPINËN. Përveç uljes, një gjest tjetër që konsiderohet jashtëzakonisht i keq dhe i vrazhdë për Mbretëreshën, është t'i ktheni shpinën.

T'ISHTRËNGONI DORËN. Kur i kush-toni homazh Mbretëreshës, gjithnjë duhet të përkuleni. Kjo nuk do të thotë që sovranja nuk mund duhet t'i shtrëngoje duart me bashkëbiseduesin e saj, por

duhet gjithmonë ajo që të bëjë lëvizjen e parë.

T'I KËRKONI TË SHKONI NË "TUALET". Një fjalë që kurrë nuk duhet të dëgjohet nga një anëtar i familjes mbretërore është tualet, sepse termi francez për "banjë" ose "tualet" gjykohej mjaft i vrazhdë.

TA PREKNI. Kur bëni ndonjë fotografi, t'i hidhni krahun Mbretëreshës (apo një anëtar të familjes mbretërore) është rreptësisht e ndaluar. Me përjashtim të shtrëngimit të duarve (shih kartën 5), njerëzit e zakonshëm nuk u lejohet t'i prekin (por ishte vetë Mbretëresha që theu protokollin kur vendosi të përqafohej Michelle Obama gjatë takimit me ish-zonjën e parë dhe bashkëshortin e saj).

TA PYESNI PËR "AROMËN" E SAJ. Ata që janë me fat që ta takojnë apo edhe të flasin me Mbretëreshën duhet të jenë të kujdesshëm që të mos përdorin fjalë që mund ta fyjnë atë. Dhe, e çuditshme por e vërtetë, "aromë" është njëra nga këto, kështu që në rast se është e përshtatshme zëvendësojeni termin "aromë" me "parfum".

TË PARAQITENI PARA SAJ ME DUAR BOSH. Kur vizitoni Mbretëreshën, gjith-

monë duhet të sillni dhurata, të cilat përshtaten sipas rastit.

TË BËNI 'SELFIE'. Përsa u përket fotografive, selfie është rreptësisht e ndaluar, madje edhe gjatë vizitës së fundit në Cardiff me Princin Harry, e dashura Meghan Markle ka thyer protokollin jo vetëm duke paraqitur për selfie, por edhe duke nënshkruar autografe (një tjetër gjë që nuk duhet të bëhet).

TË ECNI PARA SAJ. Ata që ecin me Mbretëreshën (p.sh., anëtarët e familjes dhe stafi) e dinë se duhet të shkojnë në ritmin e saj. Kjo do të thotë që ju nuk duhet të ecni ngadalë ose të qëndroni përpara sovranes, e cila, në rrugë, nuk ecën kurrë dhe nëse është e nevojshme mund të paraqitet nga stafi.

TË VAZHDONI TË HANI PASI KA MBARUAR AJO. Edhe darka me familjen mbretërore ndjek rregulla strikte dhe një nga më të rëndësishmet është kjo: sapo Mbretëresha të ketë mbaruar vaktin, të tjerët duhet të bëjnë të njëjtën gjë.

T'ITHONI "MËFAL". Një fjalë franceze shumë e padëshiruar në gjykatë, sepse konsiderohet e pasjellshme, është "pardon" ("keq"): në këto raste është më mirë thjesht të thuash "sorry" ("Më vjen keq").

Gërhitja rrit rrezikun për demencën

Personat që gërhasin kanë një rrezikshmëri tre herë më të lartë për të zhvilluar demencën, paralajmërojnë shkencëtarët. E njohur si apnea e gjumit, një çrregullim i zakonshëm që ul furnizimin me oksigjen dhe shkakton gërhitjen vret qelizat e trurit. Shkencëtarët australian tashmë kanë publikuar studimin e parë të këtij lloji për të zbuluar edhe trajtimin e kushteve që parandalojnë demencën. Profesoresha Elizabeth Coulson, nga Instituti i Queensland thotë se "trajtimi i apneas së gjumit redukton rrezikun e demencës". "Njerëzit që vuajnë prej saj kana tre herë gjasa më shumë të zhvillojnë sëmundjen e Alzheimer. Kjo ndodh për shkak të hypoxia-s, niveli i ulët i oksigjenit në gjak për shkak të frymëmarrjes së varfër, shkakton vdekjen e qelizave nervore", thotë ajo. Ajo ndodh kur muskujt dhe indet e buta në fytyrë zbuten duke shkaktuar bllokim të rrugëve të frymëmarrjes. Ajo interferon me frymëmarrjen, duke e ndaluar për periudha të shkurtra disa herë gjatë natës, duke ulur nivelin e oksigjenit, gjumë të shqetësuar dhe gërhitje.

LG tërhiqet nga tregu i smartfonëve në Kinë



Kompania e famshme LG Mobile është duke u tërhequr nga tregu i smartfonëve në Kinë, thuhet në deklaratat e publikuara. Lajmi vjen pas publikimit të rezultateve financiare të LG-së për vitin 2017, raporton GSM Arena. Të ardhurat rekorde të LG Electronics si një tërësi duket se janë mirë, por divizioni për celularë në veçanti ka shënuar humbje operative prej 192 milionë dollarë për tremujorin e katërt të vitit të kaluar, transmeton Koha.net. Me "konkurrencë të fortë nga brendet kineze", është cituar në mënyrë specifike në njoftimin për shtyp. Brendet kineze janë treguan shumë të ashpër në konkurrencën e tregut të tyre në shtëpi [Kinë], me sa duket - LG vlerësohet të ketë shitur vetëm 160.000 njësi në Kinë gjatë gjithë vitit 2016 nga një shifër prej rreth 480 milionë dërgesave në total. Gjithashtu, modelet G6 dhe V30 nuk janë lansuar zyrtarisht as në Kinë.

Portreti i Trumpit me monedha



Dyshja artistike ukrainase Daria Marchenko dhe Daniel Green prezantuan punën e tyre të fundit në Nju Jork. Puna e mëparshme e dyshes, "Face of War", është pikturë masive e presidentit rus Vladimir Putin, e përbërë nga 5000 predha plumbash të sjella nga vija frontale në Ukrainën Lindore. Këtë herë ata treguan një tjetër portret masiv të një kreu të shtetit, përkatësisht atë të presidentit amerikan Donald Trump. Portreti i Trumpit është bërë nga qindra monedha amerikane. Piktura me titull "Face of Money" i

mori artistëve tre muaj dhe ata zgjedhën presidentin amerikan për arsye të shumta. "Paraja bazohet në nderin dhe dinjitetin, por dinjiteti apo nderi nuk bazohen në paratë. Kjo është diçka shumë interesante për të cilën ne flasin", tha Marchenko. Green tha se ata zgjedhën të përdorin monedhat për një arsye. "Ju mund të jeni i pasur, por mund të jeni i lirë në të njëjtën kohë. Edhe nëse keni miliarda dollarë, nëse nuk keni ndonjë stil, nuk mund të konsideroheni person me vlerë" tha ai. Portreti i Trumpit është



bërë edhe nga monedhat e kuqe të pokerit, duke simbolizuar retorikën e tij. Artistët thonë se puna e tyre

portretizon një sërë emocionesh. Sipas tyre, portreti mund të duket kërenar dhe komik.

Katër kërkesa në formë të shkruar i janë nisur Qeverisë së Serbisë nga Ministria e Drejtësisë në Qeverinë e Kosovës, por asnjë prej tyre nuk është kthyer në Prishtinë me përgjigjet në lidhje me informatat që u janë kërkuar autoriteteve serbe

VRASJA E IVANOVIQIT, BEOGRADI NUK I PËRGGJIGJET PRISHTINËS



Autoritetet në Prishtinë nuk po arrijnë të sigurojnë informatat nga Beogradi në lidhje me zbardhjen e vrasjes së Oliver Ivanoviqit. Katër kërkesa në formë të shkruar i janë nisur Qeverisë së Serbisë nga Ministria e Drejtësisë në Qeverinë e Kosovës, por asnjë prej tyre nuk është kthyer në Prishtinë me përgjigjet në lidhje me informatat që u janë kërkuar autoriteteve serbe.

Qeveria e Kosovës, sipas ministrit të Drejtësisë, Abelard Tahiri është shumë e interesuar që autori apo autorët e kësaj veprë kriminale të dalin para drejtësisë. Oliver Ivanoviq, ishte qëlluar për vdekje më 16 janar, para selisë së partisë së tij në Mitrovicën Veriore. Ai ishte lider i Iniciativës qytetare "Liria, Demokracia dhe Drejtësia". Ai ishte qytetar i Kosovës, por kishte edhe shtetësinë e Serbisë, andaj ishte paralajmëruar që hetimet të përfshijnë edhe shkëmbimin e informatave ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit. Por, sipas ministrit Tahiri, autoritet serbe deri më tani nuk kanë kthyer asnjë përgjigje nga katër shkresat sa kanë dërguar autoritetet e Kosovës në adresë të Ministrisë së Drejtësisë së Serbisë.

"Gjatë kësaj jave ne do të dërgojmë edhe një kërkesë tek autoritetet serbe në Beograd, përmes së

cilës do të kërkojmë të na bëjnë të ditur statusin e këtyre katër kërkesave.

Do të thotë se ku janë. A kanë vullnet të na përgjigjen në to apo si qëndron puna", tha Tahiri për Radion Evropa e Lirë. Institucionet e Republikës së Kosovës, nënvizoi Tahiri, kanë vullnet që të bashkëpunojnë me palën serbe në Beograd, sa i përket zbardhjes së vrasjes së politikanit serb. Ministria e Drejtësisë në Qeverinë e Kosovës, tha Tahiri, i është përgjigjur Ministrisë së Drejtësisë në Beograd, në secilën kërkesë që ka dë-

guar. "Ne jemi jashtëzakonisht të interesuar që kryesit e kësaj veprë t'i nxjerrim sa më parë para drejtësisë. Kemi bërë progres jashtëzakonisht të madh në këtë drejtim. Ne kemi vullnetin që të bashkëpunojmë edhe me palën serbe, me Qeverinë e Beogradit, në rast se kanë mundësi të na ndihmojnë çfarëdo prove, që kryesit e kësaj veprë t'i nxjerrim para drejtësisë", tha Tahiri.

Të shtunën, me urdhër të prokurorit të rastit, autoritetet kompetente kanë arrestuar dy pjesëtarë të Policisë së Kosovës të na-

cionalitetit serb, në Mitrovicën e Veriut. Besim Hoti, zëvendës drejtor i Policisë së Kosovës në rajonin Mitrovicës së Veriut, tha për Radion Evropa e Lirë se ata janë arrestuar dhe suspenduar nën dyshimin se kanë kryer veprën penale manipulim me prova. "Prokurorët kanë ngritur dyshime për dëmtimet të mundshme të provave të vendit të ngjarjes. Për shkak të mospajtimin si duhet të vendit të ngjarjes. Mbi këtë bazë janë arrestuar dy zyrtarë policorë dhe janë suspenduar për 48 orë", tha Hoti. Ndryshe, edhe në mbledhjen e Kë-

29 KOMUNA TË PËRKOHSHME MBAJNË NDIKIMIN E SERBISË NË KOSOVË
Ministri serbi i Administratës shtetërore vetadministrimit lokal, Branko Ruzhiq, ka deklaruar se Serbia ndikimin e vet në Kosovë e realizon përmes 29 organeve të përkohshme komunale me ruajtjen e të cilave mbahet rendi kushtetues juridik i Serbisë. Ai, siç njofton FoNet ka shtuar se në kuadër të dialogut të brendshëm për Kosovën po bëhen përpjekje të ndihmohen 10 komunat serbe në Kosovë nga 10 komuna serbe në Serbi.

shillit të Sigurimit për Kosovën, që është mbajtur më 7 shkurt, është diskutuar për vrasjen e politikanit serb, Oliver Ivanoviq.

Ministri i Jashtëm serb, Ivica Dačić ka thënë se gjendja e sigurisë në Kosovë është kërcënim edhe për rajonin derisa, ambasadorja e Kosovës në Shtetet e Bashkuara, Vlora Çitaku, duke iu referuar vrasjes së Ivanoviqit ka thënë se autoritetet kosovare nuk do të lënë gur pa lëkundur derisa përgjegjësit të vendosen para drejtësisë. (REL)

KROACIA E SERBIA PAS DY VJETËSH FILLOJNË BISEDAT PËR KUFIRIN

Kryetarja e Kroacisë Kolinda Grabar Kitaroviq ka deklaruar se gjatë bisedave me kryetarin e Serbisë Aleksandar Vuçiq nuk kanë arritur pajtim në shumë çështje të hapura, se diku – diku janë afruar, ndërsa ka shfaqur besimin se për disa çështje të tjera në të ardhmen mund të pajtohen e t'i zgjidhin, transmeton Koha.net. Ajo ka shtuar se marrëdhëniet ndërmjet dy

vendeve brehen nga e kaluara, po ka shtuar se është mirë që të vazhdojnë bisedimet, njoftojnë mediet serbe. Ajo ka thënë se me Vuçiqin janë pajtuar që për kufirin ndërmjet dy vendeve qeveritë të fillojnë bisedimet pas dy vjetësh. Kroacia ka ngulur këmbë për respektimin e të drejtave të minoritetit kroat në Serbi.

Në bazë të nenit 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 74/2015 – teksti i pastruar) dhe nenit 20-g dhe 20-d të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik, pëlqimit të MASH nr. 12-1040/1, u.d drejtori i SHFK "Murat Llabunishiti" nga Llabunishita më datë 12.02.2018 ka sjellë vendim për publikim të:

Shpallje

Pranim të punëtorëve për kohë të pacaktuar të punës për vendet e punës në vijim:

1. **Dy mirëmbajtës të higjienës** me orar të plotë të punës në SHFK "Murat Llabunishiti", Llabunishitë.
2. **Një mirëmbajtës të higjienës** me gjysmë orar të punës në SHP në f. Tash Marunishitë.

Kandidatët duhet të përmbushin kushtet e përgjithshme me ligj dhe kushtet e posaçme sipas Rregullores për sistematizim të vendeve të punës në shkollë dhe të parashtrorjve: **dëshmi** për arsimin e mbaruar përkatës në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter, **certifikatë të shtetësisë**. Orari i punës është prej ditës së hënë deri ditën e premte me ndërrime dhe fillon – ndërrimi i parë prej ora 7 deri ora 15 ndërsa ndërrimi i dytë prej ora 12 deri në ora 20.

Pagesa fillestare me orar të plotë të punës është 12.000 den., ndërsa me gjysmë orari të punës është 6.000 den. Shpallja do të jetë e hapur 5 ditë pune nga dita e publikimit. Vendimi për zgjedhje do të silltet më së voni 15 ditë nga dita e përfundimit të shpalljes. Lutjet së bashku me dokumentet e nevojshme të parashtrorhen deri në SHFK "Murat Llabunishiti" – Llabunishitë.

Llabunishitë
12.02.2018

SHFK "Murat Llabunishiti" – Llabunishitë
U. D Drejtor,
Валон Мамуди

Republika e Maqedonisë
SHFK "Manush Turnovski" – Novo Sellë
Nr 04-78/2 nga 09.02.2018

Në pajtim me nenin 22 dhe 23 të Ligjit për marrëdhënie pune – Tekst i pastruar ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 129/2015) dhe nenit 130 të Ligjit për arsim fillor ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 103/08), dhe lajmërimit (pëlqimi i miratuar) për punësim nr. 12-14814/2 të datës 19.12.2017, të dhënë nga Ministria e Arsimit dhe Shkencës së RM, SHFK "Manush Turnovski" Novo Sellë, komuna e Novo Sellë, publikon:

SHPALLJE PUBLIKE Për plotësimin e vendit të lirë të punës në vijim për kohë të caktuar për vitin shkollor 2017/2018

1. Një punëtor për vendin e punës **Mirëmbajtës i higjienës** për kohë të caktuar dhe orar të plotë të punës, në SHP në f. Konjarevë e Vjetër, deri në kthim të punëtore nga pushimi i lindjes.

Kandidatët të cilët do të paraqiten në shpallje krahas kushteve të përgjithshme të parapara me ligj duhet të përmbushin edhe kushte të posaçme në vijim:

-Të jenë shtetas të Republikës së Maqedonisë;
-Të kenë të mbaruar arsimin fillor ose të mesëm.
Orari i punës prej ditës së hënë deri ditën e premte prej ora 05,30 deri në ora 12,30. Bruto pagesa mujore është në shumë prej 17.130,00 denarë. Afati për paraqitje është 5 ditë pune.

Lutjet së bashku me dokumentet e nevojshme të parashtrorhen në adresën në vijim: SHFK "Manush Turnovski" Novo Sellë, rr. Kl. Ohridski nr. 4 z. p. 2434 Novo Sellë, ose personalisht në arkivin e shkollës.

09.02.2018 g.
Novo Sellë

SHFK "Manush Turnovski"
Novo Sellë
u.d Drejtor
Lençe Karaçanakova

ARTHUR WAGNER, NJERIU QË DO T' I KETË TË DYJA

POPULIST I DJATHTË DHE MYSLIMAN!

Një gjermano-rus, që është politikan i AfD dhe konvertohet në mysliman prej bindjes së thellë, ka mbushur titujt e gazetave. Kush është Arthur Wagner? Reporteri i DW, Kay-Alexander Scholz u takua me të



Megjithëse ka vetëm dhjetë ditë përvojë me mediat, Arthur Wagner-it nuk i shihet që sapo i ka dhënë fund një ore të lodhshme emisioni televiziv. Ai, politikan i partisë populiste të djathtë "Alternativa për Gjermaninë" (AfD), dhe i konvertuar në mysliman, ishte i ftuar në emisionin me bisedë në gjuhën arabe të Deutsche Welles, "Shabab-Talk". Jo, ai nuk do që të heqë makiashin nga fytyra, me siguri gruas së tij do i pëlqejë kur ta shohë, thotë ai duke veshur pallton e zezë, vënë kapelen dhe duke u futur në bisedë me një kafe shqeto në dore dhe një biskotë. Telefoni i tij bën herë pas here pip. Edhe gjatë bisedës, revista "Spiegel", ZDF dhe madje "Washington Post" duan të flasin për të bërë shkrime me të, thotë ai.

Një politikan i AfD-së, një partie islamofobike, që kërkon të bëhet mysliman, si mund të bëhen këto dy gjëra bashkë. Historia e jetës e ka shtyrë që herët të bëjë gjëra që nuk janë të zakonshme, tregon Wagner, i cili para pak ditësh mbushi 49 vjeç. Ai është gjerman i Rusisë, i rritur në Urale. "Ne ishim të huajt", tregon ai. Maturën ai e ka bërë në një shkollë ku shkonin fëmijët e kuadrove të partisë. Si gjerman, atje "ke më pak vlera se një hebre", tregon ai. Ai ka qenë në gjithë Bashkimin Sovjetik. "Unë kam pasur prindër të gabuar, emër të gabuar, kjo më ka çuar në krizë identiteti shumë herët". Për pyetjen nëse ai tani sërish ka rolin e një të huaji, ai rri dëgjon dhe thotë: kjo është një paralele interesante.

GIJITHNJË DIKU NË MES

E ëma e Wagnerit ka qenë mësuese muzike, i ati programues. Biseda zhvillohet në mënyrë shumë reflektuese. Ai duket shumë i sjellshëm. Kur ka qenë i ri ka dëgjuar programet e Radios Deutsche Welle, tregon ai me krenari. Në atë kohë, më 1982, ka

dëgjuar programin për fenë dhe kishën. Pra gjëra që në Rusinë zyrtare nuk ishin të lejuara. Në rajonin ku është rritur ai feja ka qenë gjithnjë e pranishme. Por nuk kanë qenë të krishterët por myslimanët, që kanë jetuar prej qindra vitesh në zonën e Uraleve të Vollgës. 250 vjet më parë aty erdhën familjet gjermane, si ajo e Wagnerit. Në vitet nëntëdhjetë ata u "rikthyen" në Gjermani. Që kur ka qenë në Rusi ai ka studiuar gjashtë semestra matematikë. Në Gjermani e ka ndërruar drejtimin e studimeve në informatikë ekonomike. Dhjetë vjet ka punuar në shitje për një firmë që ka bërë tregti me vendet e ish Bashkimit Sovjetik. Pastaj ka arritur të bëhet shtresë e mesme, më vonë kriza e moshës së mesme, siç thotë ai. Ai u bë prift në një shtëpi fëmijësh në atheun e tij të ri në Brandenburg. Kjo i bëri mirë shpirtit tim, thotë ai. Kjo periudhë kaloi, në fund të fundit ai nuk është më i krishterë.

Paratë ai i fiton me një firmë konsultimi, që kërkon të nxisë tregtinë me atdheun e tij të mëparshëm, Republikën ruse të Bashkirisë. Kjo Republikë vlerësohet si e pasur për shkak të pasurive të naftës. Një faqe interneti tregon tre partnerët e firmës, një prej të cilës është Wagneri. Për në Ufas, kryeqytetit të Bashkirisë, ai ka fluturuar 600 herë, thotë Wagner. Jo vetëm për biznes. Atje, ku jetojnë pjesa më e madhe e myslimanizmit sunit, ai ka gjetur rrugën drejt fesë myslimane. Në këtë rrugë ai është "udhëhequr".

SI KA PËRFUNDUAR TEK MISIONI I TIJ?

Që kur ishte në programin arab Wagner foli me moderatorin Jaa-

far Abdul Karim për momentet e tij spirituale. "Unë pash diçka ... pata një përjetim ... dëgjova një zë të më fliste". Edhe në kafene zëri i tij dridhet kur flet për këto gjëra. Të gjitha ai nuk mund të flasë për to. Në këto momente ai rrezaton emocionalitet të rrallë. Edhe kush flet me ezoterikët dëgjon të flitet për "lëshimin në momente magjike". Por Wagner është e vështirë të krahasohet me temjanin dhe "om"-et e zërave. Kostum gri, këmbishë të bardhë, kravatë, ai duket serioz dhe konvencional. Megjithatë duket që ai merr vesh nga këto gjëra. Ai flet për shenjën e tij të horoskopit Ujori dhe të ashtuquajturin "rregullin shtatë vjeçar të renovimit".

Por ezoterikët, ndryshe nga Wagner nuk merren me politikë. Politika është për ta shumë racionale. Kurse Wagner do të jetë mysliman dhe politikan i AfD-së njëkohësisht. Ai i kthen përgjigje pyetjes, nëse rruga e tij ezoterike drejt myslimanizmit i ka dhënë një mision politik. Një lloj misionari "për të ndërtuar urat midis Evropës dhe myslimanizmit". Më vonë, thotë ai, do që të bëhet "kujdestar". Pastaj celulari i tij bën sërish pip. Ai flet në telefon me të bijën. Ajo është në pubertet dhe ka filluar njësoj si ai në atë moshë, të konfrontohet me fenë. Asaj i interesojnë grupet radikale të krishtera në SHBA. Në një farë mënyre kjo temë është pjesë e familjes së tij, thotë ai dhe qesh nën zë, i ungji i tij në Zvicër sapo ka kaluar nga feja ortodokse në judaizëm. Wagner ka edhe humor. Edhe në studion e televizionit ai qesh. Ai nuk është mendjemadh. Në diskutimin që bëhet në studio ai duket nganjëherë i pasigurt dhe herë pas here mbyll gojën duke ven-

dosur gishtin në buzë. Në bisedën në kafene ai është më i sigurt në vetvete.

SI MUND TË BËHESH URË MIDIS AFD DHE MYSLIMANIZMIT?

Feja është njëra anë për Wagnerin, AfD është ana tjetër. Në emisionin televiziv ai foli me forcë kundër "reklamave për homoseksualitetin siç bëhen në demonstratat e Christopher Street Day". Kjo nuk i bën mirë shpirtit të fëmijëve, kur e shohin. Tu thuash fëmijëve që homoseksualiteti është në rregull, është "politikë e gabuar gjinore".

Në tavolinë zëri i tij ngrihet kur ai kërkon mbylljen e kufijve. Sepse Gjermania nuk është më në gjendje të përballojë refugjatë. Vendi është mbingarkuar. Në këtë pikë Wagner përfaqëson krejtësisht mendimin e partisë së tij. Edhe kur thotë, përndryshe rrezikon të shpërthejë luftë civile në Gjermani, ai nxit po ashtu si AfD frikën e popullit. Por, raporti midis myslimanëve që jetojnë në Gjermani dhe atyre që sapo kanë ardhur është tek Wagneri ndryshe nga partia e tij: Sepse myslimanizmi është pjesë e këtij vendi. Ka ardhur koha që edhe AfD ta pranojë këtë. Mbase ai, mund t' i tregojë kolegëve të tij të partisë çfarë mendojnë myslimanët. Nga ana tjetër edhe myslimanët duhet të përgjigjen kur u kërkohet të bëjnë diçka për këtë vend. Kështu Wagner propozon të kthehet në urë midis AfD dhe myslimanëve.

JO KAQ SHUMË REFUGJATË, POR EDHE JO KAQ SHUMË AFD

Wagner rikosheta: Edhe për pyetjen cilin rol duhet të luajë AfD, ai flet për pozicionin e tij të cilin në parti nuk ia dëgjojnë me

dëshirë, por që përfaqësohet nga ish-kryetarja e rrëzuar e partisë, Frauke Petry: AfD duhet të bëhet e aftë për t'u futur në koalicion, më mirë si një partnere e re e një Partie të fortë Kristiandemokrate. Në një pikë Wagneri ia kalon të gjitha pikëpamjeve të AfD: Ai beson se AfD në një afat të gjatë nuk do marrë më shumë se 20 përqind. Dhe ai mendon se kjo është në rregull. Sepse një AfD e fortë nuk do i bënte mirë "paqes në Gjermani". Detyra speciale e AfD është ajo e një force konservatore dhe nacionalo-konervatore për "të ruajtur kulturën dhe shpirtin gjerman".

HAPAT E TJERË

Deri ku do shkojë ai në rrugën e tij për t' u bërë mysliman, u pyet Wagner në studio. Nga 114 sure, ai ka lexuar vetëm gjashtë të parat, thotë dhe kërkon falje. Me agjërimin ka bërë përvojat e para. Atij i duhet kohë të bëhet mysliman i mirë. Politikan është bërë në AfD. Hapi tjetër është krijimi i një fondacioni nëpërmjet firmës së tij për të çuar më tej "misionin" e tij. A do afrojë AfD edhe myslimanët, Wagner druhet se jo, por koha do ta tregojë. Nga Deutsche Welle ai largohet me hapa të lehtë, merr makinën e parkuar tek qoshja dhe shkon në shtëpi në Falkensee. Atje, ku më parë ka qenë përfaqësues i Kishës evangjeliste. Tani ai do dalë në mes të një zone, ku AfD ja islamofobike ka marrë rezultate të larta në sondazhe. A mund t' i besojë ai kolegëve të partisë, kjo nuk dihet me siguri. Dalja e tij publike si mysliman, thotë ai, ka marrë shumë kritika. Në AfD në zonën e tij, ka pasur lajme, sipas të cilave Wagnerin do donin më mirë ta përjashtonin.

PAS TRE MUAJVE PUSHIM, 19-TË VJEÇARI SHËNON DY GOLA

"Mënyra më e mirë për tu rikthyer nga lëndimi, ishin dy golat dhe paraqitjet e mira që i kisha për U 21 të Konjasporit. Jam shumë i kënaqur dhe falënderoj Zotin që gjithçka po ecën mirë. Në dy ndeshjet e fundit ku unë u riktheva pas tre muajve pushim, arrita të shënojë dhe të ndihmoj skuadrën drejt fitoreve të reja", thotë për gazetën KOHA, 19-të vjeçari nga Shkupi, Erdon Daci

Koha

Bujar KURTAJ

Shkup, 12 shkurt - Erdon Daci dhe skuadra e tij Konjaspor nuk kanë të ndalur. Dy ndeshjet e fundit skuadra e U 21 ka arritur fitore identike me 2-0, ndërsa protagonist kryesor ka qenë shkupjani Erdon Daci. Fillimisht Daci i kishte shënuar një eurogol Bashakshehirit për 2-0, ndërsa javën që shkoi shënoi golin vendimtar për 0-2 ndaj Alaniasporit në cilësinë e mysafirit. Këto gola dhe paraqitjet fantastike vijnë në momentin e duhur, pasi Erdoni për shkak të lëndimit qëndroi jashtë fushës së gjelbër për tre muaj. "Mënyra më e mirë për tu rikthyer nga lëndimi, ishin dy golat dhe paraqitjet e mira që i kisha për U 21 të Konjasporit. Jam shumë i kënaqur dhe falënderoj Zotin që gjithçka po ecën mirë. Në dy ndeshjet e fundit ku unë u riktheva pas tre muajve pushim, arrita të shënojë dhe të ndihmoj skuadrën drejt fitoreve të reja. Në skuadër të gjithë sytë i kanë tek unë dhe presin që unë të vendos ndeshjet. Jam i lumtur që deri më tani gjërat po rrjedhin mirë, shpresoj se edhe në të ardhmen do të vazhdoj me këtë temp", thotë për gazetën KOHA, Erdoni. Ndryshe, pas paraqitjeve të mira, U 21 e Konjasporit gjendet në pozitën e katërt në tabelën e klasifikimit, ndërsa sipas Dacit kjo është

DACI DHE KONJASPORI NUK KANË TË NDALUR



hera e parë që klubi po e arrin një gjë të tillë. "U 21 e Konjasporit nuk ka arritur asnjëherë në historinë e saj të jetë në krye të tabelës. Jo vetëm që jemi në mesin e katër skuadrave më të mira, por këtë sezon kemi arritur ti mundim skuadrat gjigante si Gallatasaraj, Fenerbahçe dhe Beshiktash. Jemi një grup jashtëzakonisht i mirë dhe gjithçka po funksionin sipas planit", shtoi më tej Daci, paraqitjet e të cilit dhe shokëve të skuadrës në çdo ndeshje ndiqen nga stafi teknik i skuadrës së parë të Konjasporit. "Në çdo ndeshje që e luajmë trajneri i parë i skuadrës së Konjasporit, Mehmet Ozdilek e dërgon ndihmësin e tij për të parë ndeshjet tona, derisa pas çdo ndeshje ai i merr videon e ndeshjet dhe më pas e shikojnë. Dua të them se vazhdimisht jemi nën vëzhgimin e tyre dhe nuk përjashtohet mundësia që në verë ndonjëri prej nesh të bëhet pjesë e skuadrës së parë



"Në çdo ndeshje që e luajmë trajneri i parë i skuadrës së Konjasporit, Mehmet Ozdilek e dërgon ndihmësin e tij për të parë ndeshjet tona, derisa pas çdo ndeshje ai i merr videon e ndeshjet dhe më pas e shikojnë. Dua të them se vazhdimisht jemi nën vëzhgimin e tyre dhe nuk përjashtohet mundësia që në verë ndonjëri prej nesh të bëhet pjesë e skuadrës së parë"

pjesë e skuadrës së parë", thotë sulmuesi 19-të vjeçar, i cili pas transferimit të Konjaspori para gjashtë muajve, arriti të shënojë 4 gola. "Katër gola nga pesë ndeshjet është bilanci im prej kur u transferova te Konjaspori nga KF Vardar. Sigurisht se numri i ndeshjeve dhe golave do të kishte qenë më i madh, nëse para tre muajve në ndeshjen kundër Akhisar Beledije ku unë shënova gol, nuk do të kisha pësuar lëndim, pasi një futbollist ndërhyri rëndë ndaj meje. Mirëpo, tani ajo i takon të kaluarës dhe nuk dua të rikthehem pas. Uroj që mos të pësoj lëndim dhe të vazhdoj me paraqitjet dhe golat për Konjasporin", përfundoi Erdon Daci, i cili me skuadrën turke ka nënshkruar kontratë tre vjeçare. Ndërkohë, rast për të vazhduar serinë e fitoreve dhe golave, Erdoni do të ketë të premtën, kur do të jenë nikoqir i skuadrës së Beshiktashit.



SADIKU
TREGON ARSYEN
SE PSE NUK KA
DEBUTUAR TE
LEVANTE

Jam i dëmtuar, gati për 10 ditë!

Levante u mund në derbi nga skuadra e Valencia, ndërkohë sulmuesi i ri i ekipit të La Ligas dhe i Kombëtares shqiptare Armando Sadiku nuk u grumbullua as në këtë sfidë. Derisa, debutimi i tij pritej që në ndeshjen e parë ndaj Realit të Madridit, të gjithë u habitën kur emrin e Sadikut nuk e gjetën as në listën e të grumbulluarve për ndeshjen që Levante luajti kundër Valencias. Armando Sadiku për "telesport" tha se "vonesa e debutimit ka ardhur për shkak të një dëmtimi, që do vonojë edhe për dhjetë ditë të tjera debutimin me ekipin e Levantes". Sulmuesi kuq e zi ishte një nga transferimet më të bujshme të lojtarëve të kombëtares shqiptare gjatë merkatos së janarit. Ai kaloi nga skuadra e Legias së Varshavës ku luajti për gjysmë sezoni te skuadra e Levantes vetëm në ditët e fundit të merkatos së muajit janar. Levante e bleu sulmuesin shqiptar për 1 milionë euro dhe ka nënshkruar një kontratë, që e mban të lidhur me ekipin spanjoll për dy vite e gjysmë. Ky është një hap i rëndësishëm në karrierën e sulmuesit shqiptar Armando Sadiku, i cili do të ketë fatin të luajë në një prej kampionateve më të fortë në Evropë dhe padyshim kundër dy lojtarëve më të mirë të të gjitha kohërave si Kristiano Ronaldo i Real Madrid dhe Lionel Mesi i Barcelonës.

DALIN NË SHITJE BILETAT

Interesim i madh për derbin Shkëndija - Vardari

Shkup, 12 shkurt - Skuadra e Shkëndijës bëhet gati për përballjen e xhiros së 19-të të Ligës së Parë të futbollit të Maqedonisë përballë Vardarit të Shkupit të mërkurën në stadiumin e qytetit në Tetovë me fillim në orën 14:00. Interesimi i madh i publikut për këtë ndeshje ka bërë që kryesia e klubit të merr gjitha masat për organizim të mirëfillt të kësaj përballje të rëndësishme për skuadrën kuqezi. "Për të eliminuar rrëmujat e panevojshme dhe radhët te stadiumi para fillimit të ndeshjes, biletat për sfidën Shkëndija-Vardari janë nxjerrë në shitje prej sot në mesditë dhe të njëjtat mund të sigu-

rohen në Fan Shopin zyrtar të klubit në qendër të Tetovës. Shitja do të vijojë edhe të martën dhe të mërkurën, ndërsa ditën e ndeshjes (e mërkurë) do të hapet edhe sporteli te stadiumi i qytetit. Çmimi për një biletë është 100 denarë", thonë për faqen zyrtare të klubit nga skuadra tetovare.

Cekim, ndeshja Shkëndija-Vardari luhet të mërkurën në stadiumin e qytetit në Tetovë, me fillim në orën 14:00. Ndërkohë, krahas kësaj përballje, po në këtë ditë do të zhvillohen edhe katër përballje tjera si Shkupi - Akademia Pandev, Pobeda - Pelisteri, Rabotnički - Renova dhe Sileksi - Skopje.



FYERJET DHE SHARJET NË FUSHËN E LOJËS

Nuk është e pazakonshme që në fushën e lojës të dëgjohen fyerje nga më të ndryshmet dhe sharje. Në fund të fundit, rregulli i pashkruar thotë se ajo që ndodh në fushën e lojës duhet të qëndrojë në fushën e lojës. Është një rregull që përjashton të gjitha normat etike dhe morale të shoqërisë

Një gjë e tillë ka ndodhur kur ish-lojtari Karlos Bilardo ka mësuar përmendësh emrat e bashkëshorteve të lojtarëve kundërshtarë për t'i provokuar këta të fundit me fyerje të ndryshme. "Nuk ka asnjë ndryshim mes Spanjës dhe Italisë, njerëzit e zgjuar e dinë se çfarë ndodh në fushën e lojës, është pjesë e futbollit, pjesë e spektaklit", ka thënë ish-lojtari i Valencias, Amedeo Karboni. "Më pas e gjen veten në një restorant ose me pushime me ata, siç më ka ndodhur mua me Viktor të Deportivos".

NGA FYERJET TE "SELFIE"

"Ajo që u tha në fushë nuk doli në shtyp, ata më thanë disa gjëra që unë i injorova. Tani bëhet një selfie dhe kjo gjë shkakton më shumë dhunë, nuk më pëlqen aspak", ka thënë braziliani Donato në lidhje me ndryshimet që kanë ndodhur në botën e futbollit që nga koha kur ai luante me Atletikon. "Futbolli është përplasja fizike dhe fjalë, ka njerëz që flasin në televizor dhe unë e fik sepse mund ta kuptosh se ata nuk kanë goditur kurrë një top në jetën e tyre". Najim, ish-futbollist spanjoll, ka përjetuar dy kultura të ndryshme të futbollit gjatë aktivizimit me Totenhem dhe Real Zaragoza, por ai ka thënë se kudo ka qenë e njëjta gjë. "Gjithmonë ka qenë kështu. Në momentet e nxehta thua gjëra që zakonisht nuk do t'i thoshe", ka thënë ai. "Në Angli përfundon në një lokal me kundërshtarin, është më e ndershme, ndërsa latinët përfitojnë më shumë nga situata".

Një tjetër që ka reflektuar mbi rregullin e pashkruar të futbollit ka qenë Poli Rinkon, një hero i Betis. "Është një kod që ekziston në futboll, kështu ishte në kohën time, paguhesh për të duruar fyerjet", ka thënë ai. "Nuk mbaj mend lojtarë që të ankoheshin në shtyp, luftonim deri në vdekje, por më pas përsëriteshim 'shihemi më vonë, gjithë të mirat'. Unë nuk do të ankohesha kurrë para mikrofonave dhe të thosha 'ata më fyen në këtë apo atë mënyrë'. Njëri nga dëshmitarët e kësaj situatë ka qenë ish-arbitri Raul Garsia de Loza. "Ashtu ka ndodhur dhe vazhdon të ndodhë. Ti i dëgjosh, por nuk i jep shumë rëndësi", ka thënë ish-gjyqtari. "Argjentinasi dhe uruguainasi kanë qenë ata që kanë folur më shumë, ndërsa ishte shumë e vështirë të provokoje anglezët dhe gjermanët. Duhej të ishte një psikolog për t'i provokuar ata". Një tjetër ka qenë ish-kapiteni Pablo Alfaro, një nga lojtarët më të ndëshkuar me kartonë në La Liga. "Është



një rregull që nuk është shkruar askund dhe ka qenë kështu që nga koha kur nuk kishte shumë kamera", ka thënë Alfaro. "Tani shikon gjithçka në fushë, në stol, por gjithmonë janë thënë shumë fjalë".

MIQ DHE PROVOKIME

Të izoluar nga loja, portierët kanë një këndvështrim unik të asaj që ndodh para tyre, duke përfshirë edhe argjentinasi Leo Franco. "Është diçka që ndodh sepse është një karrierë e gjatë dhe një rival mund të bëhet shoku jot i skuadrës ose e kundërta", ka thënë ai. "Pas shtrëngimit të duarve, miqësia harrohet, mbetet vetëm rivaliteti. Tani shikon lojtarët që takohen, puthen, i japin dorën njëri-tjetrit në tunel dhe kjo ndodh sepse janë shokë në kombëtare apo shokë të shkove. Por gjithçka mbetet në fushën e lojës". Rinkon ka shpjeguar pse ndodh kjo gjë: "Strategjia është që të shpërqendrosh kundërshtarin, ta bësh atë të humbasë durimin". Naiim ka shtuar se: "Thuhen shumë fyerje dhe bëhen shumë kërcënime, por që nuk funksionojnë kundër lojtarëve me personalitet".

NAJIM, "ANFIELD" DHE KAPITENI I TIJ

"Ka lojtarë që acarohen me lehtësi", ka vazhduar Franco. "I jep një goditje dhe ata acarohen, i thua diçka dhe nuk duan t'ia dinë, kurrë nuk kanë pasur ndikim tek unë". karboni ka shtuar se: "Ne jemi latinë, fyerjet ndaj nesh janë të zakonshme". Ndërsa, Garcia de Loza ka thënë: "Lojtarët duan të fitojnë ndeshjen, por arbitrit nuk i intereson kjo. Në kampionatin argjentinasi, kur San Lorenzo u ndesh me River Plate, Viktorio Koko ka kërcënuar Beto Alonson se do t'i priste boll... 'Mbylle gojën, ti o mut' ka qenë përgjigja dhe ndeshja vazhdoi si zakonisht". Edhe Najim ka pësuar fyerje në fushën e lojës, edhe nga kapiteni i tij. "Në 'Anfield', kur luaja me Totenhemin, simulova sikur kisha marrë një goditje me bërryl dhe u shtriva në fushë", ka thënë ai. "Kapiteni im, Garuj Mabbutt, erdhi tek unë dhe më tha 'ngrihu, mut'. Pas pjesës së parë trajneri im, Terry Venables, më zëvendësoi. Shtypi e pasqyroi këtë dhe unë nuk e bëra më".

GJUHA E KARBONIT

Njohja e italishtes i ka kushtuar shumë Karbonit në fushë: "Në Itali themi gjithmonë 'vaffanculo', në Spanjë 'cabron'. Kur arbitri më paralajmëronte, gjatë kohës që

luaja në Spanjë, unë thosha 'vaffanculo' dhe merrja karton të verdhë. Ai kuptonte vetëm fjalën 'culo', kështu që unë duhej të tregohesha më i kujdesshëm". Donato, nga ana tjetër, u sulmuar edhe për faktin se ishte besimtar. "Më kanë thënë gjëra në lidhje me biblën për të më provokuar, dikush më tha 'shumë Bibël dhe aspak fuqi'".

GJUNJËT E RINKON

Vetë Rinkon ka marrë kërcënime nga më të ndryshmet. 'Poli, po më kalove do të t'i thyej të dy këmbët dhe nuk do të shkosh dot në Kupën e Botës', i ka thënë një kundërshtar. "Unë e mora me të qeshur, ata ishin qendërmbrojtës të vërtetë". Garcia de Loza ka folur për marrëdhënien e lojtarëve me arbitrin: "Duhej të mbaje një distancë me lojtarët, si arbitër. Ata më thoshin 'bravo, arbitër' unë i përgjigjesha 'mendon për të luajtur'. Alfaro ka kujtuar: "Në sezonin kur debutova me Real Zaragoza në 1989-ën kam luajtur kundër Hugo Sanchez, ka qenë si të bëje një masters në 90 minuta. Ai më tha gjëra, më tërhoqi, më goditi. Këto janë gjëra që nuk mund t'ia shpjegosh trajnerit tënd".

MBLEDHJET E LEO FRANKOS

Franco i provokonte kundërshtarët e tij në goditjet nga këndi. "I flisja shokëve të ekipit për rivalët dhe bërtisja në mënyrë që ata ta dëgjonin, çfarë gabimi, ai duhej të kishte shënuar". Vitin që Atletiko kishte Aguero, Maksi Rodriguez, Ever Banega dhe Diego Forlan kemi qeshur shumë. Unë isha portier dhe nuk ndikohesha nga ajo që më thoshin kundërshtarët sepse nuk mund të lija portën dhe t'i ndiqja për 30 metra. Njerëzit nuk mund ta imagjinojnë atë që thuhet në dhomat e zveshjes ose në fushë, do të tronditeshin. Asgjë nuk përjashtohet, nga mamaja te ngjyra e lëkurës, por asgjë nuk del jashtë fushës".

SLOGANI I DONATOS

"Në Brazil pëlqejnë shumë të të poshtërojnë, si në Spanjë, por atyre nuk u bën përshtypje. Situata ndryshon nëse më ofendon në rrugë", ka thënë Donato. "Unë kisha një slogan për rivalët: 'Nëse do probleme, do t'i gjes'. Tani lojtarët mbulojnë gojën me dorë, por ne nuk mbulonim asgjë. Madje, tani kanë filluar edhe të lexojnë buzët". Në fund, Garcia de Loza ka kujtuar se Emilio Butragegno dhe Pep Guardiola kanë qenë lojtarët më të sjellshëm.

JAJME SHKURT

Laipzig nuk lejon largimin e Verner

Timo Verner nuk ka shanse të largohet nga Leipzig. Është ky mesazhi i fortë që jep Ralf Rangnik për klubet e mëdha evropiane, që dëshirojnë "bomberin" gjerman për sezonin e ardhshëm. Drejtori Sportiv i klubit tha se ia ka bërë të qartë edhe sulmuesit 21-vjeçar se ai do të qëndrojë edhe sezonin e ardhshëm te Leipzig, por shtoi se ka nisur bisedimet me menaxherin e tij për të përmirësuar pagën e lojtarit me një rinovim tjetër të kontratës. Verner është pjesë e Kombëtares së Gjermanisë dhe mund të rezultojë zbulimi i Botërorit "Rusi 2018". Drejtuesit e Leipzigut shpresojnë që futbollistë të spikasë në evenimentin me të rëndësishëm të sportit në verë, në mënyrë që çmimi i kartonit të tij të rritet më shumë.

Betis gati të kthejë Alex Song

Aleks Song mund të përsërisë aventurën e tij në Primera Divizion. Ish-lojtari i Barcelonës, i cili së fundmi luante për Rubin Kazan, por që ndërpreu kontratën për arsye financiare, është i lirë për të firmosur me çdo ekip. Real Betis po insiston me më shumë për të siguruar shërbimet e kamerunasit. Mesfushori po stërvitet me Arsenalin për të qenë në formë, ndërsa bisedimet me Betisin janë shumë pranë finalizimit. Song do të ishte goditja e dytë e madhe për klubin pas afrimit të Mark Bartra në janar.

Napoli preferon Palettan

Dëmtimi i rëndë që pësoi Goulam ka vënë në vështirësi drejtuesit e Napolit, të cilët po kërkojnë një zgjidhje për repartin e tërhequr të skuadrës. Pas Guilerme Siqueiras, i cili është pa kontratë që nga vera e kaluar pas largimit nga Atletiko Madrid, emri më i mundshëm për të mbushur repartin e mbrojtjes është ai i Gabriel Palettas, edhe ky pa kontratë që nga janari kur u largua nga Milani. Paletta mund të jetë alternativa më e mirë për momentin, pasi nuk ka nevojë për të punuar shumë që të gjejë formën maksimale, ndryshe nga emrat e tjerë që nuk luajnë që nga vera e kaluar.

Ganso kërkon largimin për Botërorin

Ganso i ka ditët e numëruara te Sevilja. I lënë në hije fillimisht nga Berizzo, por tani edhe nga Montella, fantazisti brazilian po mendon largimin e menjëhershëm nga ekipi spanjoll. 28-vjeçari në prag të Botërorit shpreson të gjejë një ekip që i jep hapësira në fushë dhe Vasco da Gama është gati ta bëjë një gjë të tillë. Ideja më e fundit e lojtarit është të prishë kontratën me Seviljan dhe nëse e bën një gjë të tillë mund të qëndrojë ende në Evropë, pasi për të interesohen Benfica, Porto dhe Sporting Lisbona.

Pas një pauze, rikthehen ethet e Ligës së kampionëve, ku sonte (e martë) në program do të jenë ndeshjet e 1/8 së finales. Në program do të jenë dy përballje, ajo mes Bazelit dhe Mançester Sinit dhe Juventusit dhe Totenhemit

LIGA E KAMPIONËVE, 1/8 E FINALES

TOTENHEMI PËRBALLË NJËRËS PREJ SKUADRAVE MË TË MIRA NË EVROPË



DYSHET:

BAZEL - MANÇESTER SITI
JUVENTUS - TOTENHEM

BARZALINË DYSHIM

Andrea Barzagli është dyshim serioz për praninë e tij në radhët e Juventus për ndeshjen kundër Totenhemit. Barzali nuk mori pjesë në stërvitjen që zhvilloi "Zonja e Vjetër", dje paradite, si pasojë e një problemi muskolor në kofshën e djathtë. Teorikisht dëmtimi i Barzali nuk është shumë i rëndë, por ndoshta "veterani" do ta ndjek nga tribuna atë që është ndeshja më e rëndësishme e Juventusit deri në këtë pikë të sezonit. Në dyshim serioz është edhe prania e Paolo Dybala, që ende nuk është riaftësuar nga tërheqja muskulore e pësuar në fillim të janarit. E sigurt është që te skuadra e Alegriti do të mungojnë: Kuadrado, Hovedes dhe Matuidi.

për të vazhduar më tutje konsiderohen anglezët e Sinit, të cilët këtë sezon po luajnë jashtëzakonisht mirë si në Premier Ligë poashtu edhe në Ligën e kampionëve.

Në "Allianz Stadium" sot (e martë) do të luhet akti i parë i ndeshjes mes Juventusit dhe Totenhemit, i vlefshëm për 1/8 e finales të Ligës së Kampionëve. Ndeshja e parë do të zhvillohet në Torino, në ora 20:45. "E kemi dëshmuar tashmë edhe me Real Madridin, se mund të jemi kompetitiv. Na presin dy ndeshje entuziazmuese. Çampions është një kompeticion i veçantë. Do të përballemi me një prej skuadrave më të mira në Evropë. Ne jemi në formë të mirë dhe duam të vazhdojmë në këtë rrugë. Kjo do të jetë hera ime e parë në Itali, në Torino do të jetë speciale", deklaroi trajneri i Totenhemit, Poketino. "Do të jetë një ndeshje shumë e vështirë, por të cilën pres me padurim që ta luaj. Duam gjithmonë të përballemi me më të mirët dhe Juve është një skuadër e madhe. Duhet të shfrytëzojmë këtë moment favorit", deklaroi Kin. Ndërkohë, trajneri i Juventusit, Masimiliano Alegri, ka folur për kundërshtarit e sotëm. Kujtojmë, "Zonja e Vjetër" ka qenë dy herë finaliste në tri edicionet e fundit. "Wembley' na pret, një nga tempujt e shenjtë të këtij sporti. Futbollistët e Totenhemit janë të rinj dhe të talentuar, por nëse ne do të jemi Juve e vërtetë, atëherë

do të kemi sukses", deklaroi Alegri. Ndryshe, parashikohet që Alegri të aplikojë modulën 4-3-3, por me disa ndryshime në krahasim me transfertën e fundit ndaj Fiorentinës të cilën bardhezinjtë e fituan me rezultatin 0-2. Në krahun e djathtë, mbrojtësi De Shilio është i favorizuar para Lihstainer, ndërsa në "trident" duhet rifituar një vend, duke filluar në kurriz të Bernardeski dhe Daglas Kosta. Në

mes të fushës, Bentankur dhe Sturaro luajnë për një fanellë, ndërsa konfirmimi i Markisio është i vështirë. Në anën tjetër Poketino duhet të vendosë 11-shin që mundi Arsenalin në derbin e Londrës së Veriut. Alderveireld dhe Ros në dyshim, ndërsa në vendin e tyre do të jetë Sançez dhe Dejvis, në mbrojtje. Dajer dhe Dembele do të jenë dy "filtrat" e përparme, në mes të mbrojtjes. Në fazën ofensi-

ve, si zakonisht, Totenhemit pritet të luajë me katër: Bir, Eriksen dhe Alli, prapa Kin, me Lamela të gatshëm për të marrë përsipër detyra në këtë funksion. Derisa, ky ballafaqim do të drejtohet nga gjermani Bryh, i cili ka qenë arbitri i finales së vitit të kaluar në Kardif, e humbur nga bardhezinjtë kundër Real Madridit. Në përballjen tjetër, Mançester Siti do të jetë mysafir i Bazelit. Favorit i padiskutueshëm

RRUMBULLAKOSI 300 NDESHJE

MESSI, HEROI I MADH I "CAMP NOU"

Si zakonisht, Leo Messi është protagonist para dhe pas lojërave. Këtë herë, lojtari më i mirë në botë bëhet i rëndësishëm në vërtetimin e barazimit Barcelona-Getafe 0-0, pasi kjo ishte ndeshja e tij e 300-të zyrtare me fanellën e Barcelonës në "Camp Nou". Dhe nëse shifra tashmë flet vetë dhe zbulon peshën specifike, që ylli argjentinas ka në ekipin katalanas, jo më pak spektakolare është përqindja e fitoreve që ai kishte grumbulluar përgjatë 299 lojërave që kishte luajtur para barazimit të fundit me Getafen: 82.2 për qind. Por, ka edhe më shumë. Ai ka shënuar 309 gola të dendur, në një mesatare prej 1.03 golash për ndeshje në shtëpi. Edhe më shumë: nga 299 lojërë të luajtura para së dielës së djeshme, në 266 prej tyre ka qenë një startues (88 për qind). Mund të jetë e sigurt, pa dyshim, që Leo Messi është heroi i madh i "Camp Nou". Shifrat që ka grumbulluar e ngrenë atë në kate-



gorinë e idhullit total. Argjentinas i ka arritur të gjitha të dhënat e vendosura nga paraardhësit te Barcelona dhe po i tejkalon ato në mënyrë të tillë, sa vështirë të ketë një lojtar tjetër, që mund t'i përmirësojë ato. Arritjet e "Rosarino" janë kaq kolosale, sa kur të "varë çizmet në gozhdë", numrat e tij nuk mund të bien kurrë në harrësë. Në këto 299 ndeshje, pa llogaritur atë të djeshmen, e barazuar 0-0 me

Getafen në "Camp Nou"; përveç golave, fitoreve dhe startimeve, del në pah një skuadër prej 48 lojërash radhazi, në të cilat Messi nuk e njihë humbjen. "10" midis 14 shtatorit 2010 dhe 10 prillit 2012, kur fitoi 42 ndeshje dhe barazoi 6 të tilla, përveç shënimit të 66 golave. Periudha të tjera u nënshkruan në mes të marsit 2015 dhe 2016 (29 duele pa rënë në gjunjë), apo midis shkurtit 2007 dhe majit 2008 (28 ndeshje).

Nga garat, natyrisht, Messi akumulon më shumë ndeshje në La Liga (ka luajtur pikërisht 200 të tilla, kundër Deportivo Alaves, më 28 janar). Në Ligën e Kampionëve regjistron 56 ndeshje, Në Kupën e Mbretit 34 ndeshje, në Superkupën e Spanjës 9 ndeshje. Dhe sa u përket golave: 212 gola në La Liga, 55 gola në Çampions, 31 gola në Kupën e Mbretit dhe 11 gola në Superkupën e Spanjës. "Viktima", e cila

ka pësuar më shumë gola nga ylli argjentinas, në shumë raste ka qenë Sevilja (19 gola), e ndjekur nga Espanjol (18 gola), Atletik, Osasuna dhe Valencia (16 gola). Vizitori i djeshëm në "Camp Nou", Getafe, kishte pësuar 11 gola nga Messi. Nga ana e tij, Real Madridi ka pësuar 10 gola, ashtu si Levante dhe Real Sociedad. Goli i tij i parë u shënuar kundër Albasete. Është fakt interesant se Messi kurrë nuk kishte dështuar në "ndeshjet e rrumbullakëta", që ai ka luajtur në "Camp Nou". Ai fitoi të parën (kundër Osasunës, 3-0), të 50-tën (kundër Levante, 5-1, shënoi një gol), të 100-tën (kundër Deportivo, 3-0), të 150-tën (kundër Bajer Leverkusen, në Çampions, 7-1, realizoi një repoker), të 200-tën (kundër Betis, 3-1, realizoi dopietë) dhe të 250-tën (kundër Arsenalit, në Çampions, një gol). Dështoi në ndeshjen e tij të 300-të në "Camp Nou", pikërisht dje, ndaj Getafes, ku barazoi dhe nuk shënoi dot gol.



Jack Daniel's krijon kafe me shije të uiskit

Pjesa më e mirë e të zgjuarit nga gjumi? Kafja Jack Daniel's në filxhanin tuaj, natyrisht. Jack Daniel's ka "kërcyer në karrocën" e kafesë dhe ka filluar të krijojë prodhimin e vet me shijen si të uiskit. Ata kanë filxhanët e tyre të kafesë, të udhëtimit dhe shumë gjëra të tjera. Ndryshe nga kafja irlandeze, me kafënë Jack Daniel's nuk mund të deheni,

meqë nuk ka përmbajtje alkooli. Kokrrat janë të zhytura në uiski për një periudhë të gjatë kohore, por procesi i pjekjes e largon çdo mbetje të alkoolit, duke e lënë aromën e thellë dhe të bukur të kanellës në to. Së shpejti presim ta shohim aktorin e famshëm George Clooney duke konsumuar një JD-spresso.



Përse na zë lemza?

Pjesa më e madhe e njerëzve përjetojnë lemzën, një eksperiencë të paretshme, shqetësuese dhe afatshkurtër. Por ndonjëherë lemza zgjat për një kohë të gjatë dhe mund të jetë shenjë e një sëmundjeje serioze. Çfarë është lemza? Lemza është kontraktim i pavullnetshëm i muskullit të diafragmës. Rastet më të zakonshme të lemzës vijnë pas të ngrënës ose të pirit me sasi të mëdha ose shumë shpejt. Stomaku që është i vendosur poshtë diafragmës, fryhet dhe e irriton atë. Kjo shkakton kontraktimin e diafragmës. Ndonjëherë lemza do të ndodhë për shkak të një shqetësimi në rrugët nervore. Kjo shpjegon arsyen se përse lemzat mund të ndodhin edhe me ndryshimet e temperaturës ose me situatat emocionale. Lemza e vazhdueshme mund të nënkuptojë probleme në tru, palcën kurizore apo në çfarëdo strukturë përreth diafragmës. Çdo njeri mund të trajtohet me ilaçet përkatëse për shërimin e lemzës.


Përse nuk do të na duhet më telekomanda e televizorit?

Do të mjaftojë lëvizja e një pjese të trupit, falë një teknologjie të re të quajtur "matchpoint", që është vënë në zbatim nga universiteti britanik i Lancasterit.

Për të kontrolluar funksionet e ndryshme nevojitet lëvizja rrethore e një rës dorë, kokës apo edhe një këmbë, që kapet prej një kamere. Një herë që pjesa e trupit asocionet me funksionin që duhet kontrolluar (përshtet mund të ndërrohen kanalet duke rrotulluar kokën), në video shfaqet një kursor që me të cilin mund të "rrisësh" apo "ulësh".

Sistemi zbulon lëvizjet dhe jo pjesët e trupit (apo objektet), prandaj funksionon edhe kur i ke duart e zëna, për shembull. Sipas ideuesve, kjo teknologji e re, që në teori funksionon edhe me lëvizjet e një makine lodër, është e dobishme mbi të gjitha kur po bën një gjë tjetër, apo thjesht për të mos ndryshuar pozicionin kur po relaksohesh në divan.

Dhe nuk funksionon vetëm me televizorin: mund të përdoret edhe në PC dhe tablete për të kontrolluar një video, pa patur nevojë për mouse apo ekran me prekje.



Zbulohet kodi sekret i Apple!



Një përdorues, i cili ka mbetur anonim, ka arritur të zbulojë së fundmi një komponent kyç të kodit burimor të iOS në GitHub. Tashmë Apple e ka tërhequr kodin, por jo përpara se miliona përdorues ta shkarkonin atë. Apple u detyrua të përdorte "Aktin Për Mbrojtjen e të Drejtave Dixhitale të Autorit" për të hequr kodin duke konfirmuar se ka qenë i vërtetë. Kodi i përkiste iOS 9.3

dhe është publikuar në Pranverë të 2016-ës. Ai quhej iBoot dhe siç emri sugjeron kontrollonte procesin e "boot-up" sa herë që ndizni iPhone. Ndërsa mund të konsiderohet si diçka e madhe, rrjedhja e informacionit është gjithashtu e rrezikshme në këtë rast. Situata është kaq e ndjeshme sa që Apple paguan deri në 200,000 dollarë ata që gjejnë probleme sigurie në kodin në fjalë.

1258 - Bagdadi bie në duart e mongolëve dhe shkatërrohet kalifati abasit.

1633 - Astronomi italian Galileo Galilei arriti në Romë për tu gjykuar para Inkuizionit për shkak të besimit se toka rrotullohet rreth diellit.

1832 - Paraqitja e parë e kolerës në Londër.

1920 - Lidhja e Kombeve njeh neutralitetin e përvetshëm të Zvicrës.

1945 - BRSS merr Budapestin pas betejës 49 ditore me Gjermaninë; 159,000 të vdekur.

1959 - Kukulla Barbi del në shitje.

1974 - Disidenti, shkrimtari fitues i Çmimit Nobel, Aleksander Solzhenitsyn dëbohet nga BRSS.

1989 - Lirohet Kryeministri i kidnapuar belg Vanden Boeynants.

Ndryshe nga ujku, cilësitë e qenit në komunikim dhe ndërveprim me njeriun mund të jenë të ndërlidhura me ndryshimet gjenetike. Një hulumtim i realizuar nga një grup shkencëtarësh amerikanë të disiplinave të ndryshme, rezultatet e të cilit janë publikuar në revistën "Science Advances", ka treguar se qentë të cilët njihen si miqtë më të mirë të njeriut kanë një lloj të ndryshimeve të kromozomeve, i cili njihet si "Sindroma Williams-Beuren". Në kuadër të këtij hulumtimi shkencëtarët të cilët kanë observuar se disa pjesë të ADN-së së qenve kanë ndërlidhje me sjelljet sociale, kanë thënë se Sindroma Williams-Beuren mund ta shpjegojë arsyen e dashamirësisë së palëkundur të qenve. Shkencëtarët vënë në dukje se shtojcat gjenetike të vetme të cilat në Sindromin Williams-Beuren njihen si "transposone", mund të shpjegojnë arsyen e kontaktit fizik, afrimin tek njerëzit me kërkim të njohurive dhe të ndihmës.



POLICIA NË VENDIN E KRIMIT

Një grua vret burrin dhe policia mbërrin në vendin e krimit. Polici merr shëf në radio për ti raportuar ngjarjen: - Shef, gruaja e ka goditur trupin rreth 6 herë me thikë dhe rreth 12 herë me pistoletë dhe e ka hedhur nga kati i 7. - Po a arritët të zbuloni se cili ka qenë shkak i kësaj vrasje? - Po shef, gruaja i kishte thënë burrit që të mos kaloj mbi dyshe me deri sa ajo të thahet! - Po mirë, po gruan e keni kapur? - Jo shef akoma, po presim të thahet dysheja!



I dobëti nuk mundet të falë kurrë. Falja është cilësi e të fortit. (Dr. Abdul Kalam)